# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7480 E martë 27 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Korça Beer edhe sot më e mira ...

Korça Beer edhe sot më e mira ...

Opinioni i Ditës

Nga VALBONA NATHANAILI



### A duhet lejuar komuniteti LGBT të zhvillojë orë të hapura në shkolla?

Ka disa javë që aktivistë të komunitetit LGBT po zhvillojnë disa leksione dhe orë të hapura në shkolla të mesme në Tiranë dhe në qytete të tjera. Shqetësimi ... Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga MONIKA STAFA



### Vetëvrasja - turpi që na mban ende mbërthyer

Një grua hidhet nga kati i katërt i një pallati diku nga meskoriku i vitit të kaluar në një periferi të kryeqytetit; një tjetër sërish ka zgjedhur këtë ... Vijon në faqen 21




Nga viti '93 deri në '97 iu njoh prona 17.400 vetëve

## Vendimet e viti 1997, emrat e 1462 pronarëve që kompensohen, lista e parë me përfituesit

Agjencia e Trajtimit të Pronave: Keni dhe 4 muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Nga ORNELA MANJANI

Artistët janë mbledhur dje para Teatrit Kombëtar për të kundërshtuar shembjen e tij. "Rama të ndiqet penalisht" tha Rudi Sata, kryetar i Sindikatës së Artistëve dhe Punonjësve të TKOBAP. Ai ka bërë thirrje që ...

Në faqet 16-19

MINISTRI I JASHTEM I KOMUNIKON AMBASADORIT KARPUSHIN EMRAT, JA KUSH JANE

# HELMIMI I ISH-SPIUNIT RUS, SHQIPERIA DEBON 2 DIPLOMATË

Rama në Grupin e PS: Veprim i koordinuar me vendet e NATO-s. Ministria e Jashtme ruse: Keqardhje, gjesti i BE-SHBA, provokativ dhe i pabazuar



*(Në foto)* Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati dhe ambasadori rus në vendin tonë, Aleksandër Karpushin

Në faqen 3

NDEROHEN POLICET

### Rama: 2018, viti më i zi për krimin Xhafaj: Iku koha kur goditej policia

Në faqen 2

UNIFIKOHEN QENDRIMET

### Opozita e bashkuar: Nuk ndalemi deri në largimin e Ramës, Kryemadhi: Ai është gjenerator i krimit

Në faqen 5

REAGON KRYEMINISTRI

### Tarifa 10 euro, bizneset bojkotojnë 'Rrugën e Kombit', Bytyçi: Plaçkitje. Kolgjini: Mos paguani

Në faqen 6

PAS PEZULLIMIT

### Ligji 7501, Gjonaj: Verifikim të titujve të pronësisë, kemi nisur reformën e pronave

Në faqen 7

SPIRO PAÇO: KUMTESAT QE U PREZANTUAN



### "Luarasi", simpozium për figurën e Skënderbeut, themeluesi Aleks Luarasi: Debati shkencor, pasurim

Në faqen 13

Protesta, Suela Konjari: Situata më kujton komunizmin që shembi kisha e xhami

## "Të bëhet referendum popullor, s'kemi luks ta shembim"

*Artistët: Kryeministri Rama të ndiqet penalisht, shemben dy teatro*

Nga FATMIRA NIKOLLI

Artistët janë mbledhur dje para Teatrit Kombëtar për të kundërshtuar shembjen e tij. "Rama të ndiqet penalisht" tha Rudi Sata, kryetar i Sindikatës së Artistëve dhe Punonjësve të TKOBAP. Ai ka bërë thirrje





që kryeministri Edi Rama të ndiqet penalisht, ndërsa ka deklaruar se nuk do të lejohet që të shembet Teatri Kombëtar. Dëgjesa e artistëve u bë në oborrin para Ministrisë së Brendshme mes dy godinave të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit ...

Në faqen 14

# AKUZAT PER PRONEN

## SQARIMI

Deputeti i PS shmang përgjigjen për mediat: Pyesni institucionet

# Akuzat për vjedhjen e 11 mijë metër tokë në Dhërmi, Balla-Hysenit: Sqaro publikun

## *Krimet e Rënda nisën hetim për rastin*

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla i kërkoi dje, deputetit Alket Hyseni të sqarojë pozicionin e tij, në lidhje me akuzat e ngritura nga qytetarja Irini Bua dhe opozita për përvetësimin e 11 mijë metra katrorë tokë në Dhërmi. Burime nga mbledhja e Grupit Parlamentar të PS-së bënë me dije se kreu i grupit e ka hapur këtë çështje para deputetëve dhe të kryeministrit Rama, duke thënë: "Deputeti Hyseni më ka njohur me rastin pas akuzave nga opozita. Nga informacioni që më ka dhënë rezulton që akuzat të jenë politike dhe deputeti thotë se prona është blerë konform ligjit dhe të ardhurave të ligjshme. I sugjerojmë deputetit të japë shpjegime për publikun për këtë çështje përmes gjithë dokumentacionit që disponon". Vetë deputeti Alket Hyseni ka sqaruar pozicionin e tij, para kolegëve për mënyrën se si ka blerë këtë pronë, duke theksuar se zonja që bërë akuzën publike ndaj tij, është rrëzuar 8 herë nga institucionet vendimmarrëse. Ndërkohë dje, i pyetur nga media, se ku i kishte gjetur paratë e blerjes së pronës, Hyseni dha këtë përgjigje. "Ikni pyesni institucionet". Kryeministri Rama mësohet t'i ketë thënë Hysenit që t'i sqarojë këto akuza edhe publikisht. Ndërkohë vetë deputeti, sipas deklarimit që ka bërë në ILDKP figuron të jetë një nga njerëzit më të pasur të Grupit Parlamentar të PS-së dhe 140 deputetëve të Kuvendit me dhjetëra metra tokë si dhe apartamente, e llogari bankare. Pak ditë më parë, zonja Irini Bua e akuzoi Hysenin se i ka vjedhur 11 mijë metra tokë në Dhërmi. Ndërkohë Prokuroria e Krimeve të Rënda tha në rrugë jo zyrtare se, në fakt, për këtë denoncim ka nisur hetimet sipas një kallëzimi të dorëzuar më herët pranë organit të akuzës. Bëhet me dije se dosja është regjistruar për veprat penale të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës dhe vjedhjes tha një pjesëtar i grupit të hetimit. Por nuk ka ende një person konkret nën hetim pasi prokurorët e Krimeve të Rënda kanë urdhëruar mbledhjen e dokumentacionit edhe nga institucionet shtetërore. Ndërsa dje, në një tjetër reagim kunati i Irini Bua, Stefo Buo kunati i zonjës tha se pretendimet e saj janë të pabaza dhe se 22 mijë metër katror janë të "paprekura", ndërsa pronat i ka përfituar nga testamenti i nënës së tij i vitit 1986. Për këtë testament, Irini Buo thotë se atëherë nuk ekzistonte ideja e tokave, ndërsa Stefo Buo shprehet se testamenti i përket për shtëpinë dhe gjithçkaje që rrjedh pas.



Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla

**ALKET HYSENI**

"Toka bujqësore është fituar nga një AMTP(tapi) në emër të kunatit të zonjës që akuzon, e marrë para dhjetëra vitesh dhe e regjistruar me vendim gjykate. Është transferuar me kontratë noteriale para disa viteve tek një person i tretë, përpara se të kalonte në pronësinë time të përkohshme. Nuk e njoh fare përfituesin fillestar të kësaj prone",-tha Hyseni pak ditë më parë.



Grupi i PS-së

**POROSITË PËR DEPUTETËT**

Kryeministri Edi Rama i porositi dje, deputetët socialistë që të vijojnë me deklaratat e tyre në lidhje me financimin rus të PD-së dhe akuzat ndaj Lulzim Bashës. Po ashtu kryeministri Rama ka porositur deputetet që të shpërndahen në zonat e tyre, duke kërkuar që të jenë aktivë.

### Tentativa e grabitjes në Fier, qeveria nderon 5 policët

# Rama: 2018, viti më i zi për krimin
# Xhafaj: Iku koha kur goditej policia

Qeveria nderoi dje, me medalje 5 punonjës të Policisë së Shtetit që morën pjesë në operacionin për parandalimin e grabitjes në Fier, ku gjatë shkëmbimit të zjarrit mes grupit kriminal dhe bluve mbeti i vrarë një nga autorët dhe u plagos një tjetër. Në një takim me punonjës të policisë, kryeministri Rama e ministri Fatmir Xhafaj vlerësuan rolin e policisë për sigurinë në vend. Kryeministri Edi Rama paralajmëroi publikisht se 2018-ta do të jetë viti më i zi për krimin e organizuar. "Nuk ka diskutim që ky vit do të shënojë një marrëdhënie të re në përballjen e policisë me krimin e organizuar, pasi do të jetë viti më i zi për krimin e organizuar. Vitet do të shkojnë duke u nxirë për krimin organizuar dhe elementet kriminale që janë të përfshirë në këtë organizata. Operacioni 'Forca e Ligjit' ka dhënë rezultate që tregojnë atë që kemi pritur, rezultate shumë premtuese për hapat në vijim", tha Rama. Nga ana e tij, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj u shpreh se si asnjëherë tjetër më parë, policia ka zbardhur të gjitha ngjarjet e fundit kriminale duke vënë pas hekurave edhe autorët. Ai tha se reforma në drejtësi e iniciuar nga mazhoranca po jep frytet e para dhe se Policia e Shtetit është në fazën e vetingut. Ai përmendi edhe rastin e vrasjes nga policia drejt të riut hajdut që qëlloi drejt policisë duke thënë se koha kur kriminelët çonin dorë mbi policët dhe nuk u hynte gjemb në këmbë ka përfunduar.





# Meta takon homologen malteze, kërkon mbështetje për çeljen e negociatave me BE

Presidenti i Republikës Ilir Meta, po zhvillon një vizitë shtetërore dy ditore në Maltë me ftesë të Presidentes së Republikës së Maltës, Marie-Louise Coleiro Preca. Vizita e Presidentit Meta përkon me shënjimin e 45-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Maltës. Presidenti Meta i shprehu homologes Coleiro Preca vlerësimin për mbështetjen e pakursyer që Malta i ka dhënë Shqipërisë në procesin e saj të integrimit europian, duke kërkuar njëkohësisht mbështetjen ndaj një rekomandimi pozitiv të pritshëm të Komisionit Europian për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Të dy presidentët konfirmuan angazhimin e ndërsjellë për të nxitur qeveritë, institucionet e të dy vendeve dhe komunitetet respektive të biznesit, që të hulumtojnë dhe shfrytëzojnë të gjitha mundësitë dhe hapësirat e investimeve në sektorë strategjikë, si turizmi, energjetika, infrastruktura, sektori financiar dhe teknologjisë së informacionit. Presidenti Meta veçoi Teknologjinë e Informacionit, një fushë ku Malta ka arritur të tërheqë prezencën e kompanive globale si Microsoft, si një tjetër mundësi bashkëpunimi konkret. Duke u ndalur në zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, Presidenti Meta përcolli mirënjohjen për mbështetjen e Maltës ndaj shtetit të Kosovës, dhe nënvizoi rëndësinë që ka liberalizimi i shpejtë vizave për qytetarët saj, të vetmit në Ballkan që nuk përfitojnë ende nga regjimi i liberalizuar i vizave drejt hapësirës Shengen.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Bushati i komunikon emrat e dy zyrtarëve ambasadorit Karpushin

# Helmimi i ish-spiunit në Britani, Shqipëria dëbon dy diplomatë ruse

## *Rama në Grupin e PS: Veprim i koordinuar me vendet e NATO-s*



**VENDIMI**
Edhe 14 vende të tjera evropiane i janë bashkuar Britanisë, e cila nisi e para dëbimin e rusëve me 23 të tillë javën e shkuar. Shqipëria dëboi sot dy diplomatë ruse, duke i shpallur si të padëshirueshëm. Bazuar në raportimet e mediave, numri i rusëve të dëbuar duket të jetë 60.

Darina Tanushi

Qeveria Shqiptare kërkoi dje largimin e dy diplomatëve ruse nga vendi, pasi veprimtaria e tyre është në shkelje të statusit diplomatik. Vendimi i marrë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme i është komunikuar mesditën e së hënës ambasadorit të Federatës Ruse në Tiranë, Aleksandër Karpushin. Dy diplomatët e dëbuar nga vendi janë sekretari i parë i ambasadës, Aleksey Balashov si dhe atasheu ushtarak Vladislav Filippov, të cilët së bashku me familjet e tyre, brenda 72 orëve do duhet të lënë Shqipërinë. MEPJ njoftoi se veprimtaria e dy diplomatëve ruse në Shqipëri nuk përputhet me statusin e tyre diplomatik. Sipas njoftimit për shtyp nga ministria, nota verbale i është komunikuar ambasadorit të Rusisë në Shqipëri, Aleksander Karpushin. "Sot, në datë 26 mars 2018, në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme u thirr ambasadori i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Federatës Ruse në Republikën e Shqipërisë, Aleksander Karpushin, të cilit iu komunikua nota verbale për shpalljen si persona të padëshirueshëm të dy diplomatëve ruse, veprimtaria e të cilëve nuk përputhet me statusin e tyre diplomatik", thuhet në deklaratën zyrtare të MEPJ-së. Katërmbëdhjetë vende të Bashkimit Europian vendosën dje të dëbojnë diplomatët ruse pas helmimit në Britaninë e Madhe të ish-spiunit rus, Serguei Skripal, njoftoi presidenti i Këshillit Europian, Donald Tusk. Vendimi i Qeverisë shqiptare vjen paralelisht me aksione të njëjta të ndërmarra fillimisht nga Mbretëria e Bashkuar e më pas nga SHBA-të dhe vendet anëtare të NATO-s, të cilat kanë vendosur dëbimin e diplomatëve ruse, si shenjë reagimi ndaj akuzave për helmimin e ishagjentit Sergei Skripal me agjent kimik, rreth një muaj më parë në Britani. Kryeministri Edi Rama e njoftoi këtë vendim edhe në mbledhjen e djeshme të grupit parlamentar të Partisë Socialiste. "Qeveria do të vendosë për dëbimin e disa shtetasve ruse. Ky është një veprim i koordinuar me vendet e NATO-s. Do dëbojmë rusët që kanë shkelur interesat kombëtare", mësohet të jetë shprehur Rama në mbledhjen me dyer të mbyllura. Bazuar në raportimet e mediave, numri i rusëve të dëbuar duket të jetë 60. Ambasadori rus në Uashington ka thënë se SHBA-të janë duke shkatërruar edhe ato pak marrëdhënie që kanë mbetur me Rusinë, ka raportuar "Reuters", duke u bazuar në agjencinë e lajmeve RIA.


Kryeministri Edi Rama

**NGJARJA**
Ngjarja që po trazon botën daton në 4 mars të këtij viti, ku Sergei Skripali dhe vajza e tij Yulia u helmuan në Salisbury të Anglisë me një agjent kimik nervor që e zotëron vetëm Rusia. Pas asaj dite, Shtetet e Bashkuara kanë urdhëruar dëbimin e 60 diplomatëve ruse, ndërsa Gjermania dhe Franca kanë njoftuar, gjithashtu, se do të përjashtojnë nga 4 diplomatë ruse secila.

**AMBASADA E SHBA-VE**
Ambasada e SHBA-ve në Tiranë theksoi dje: "Shtetet e Bashkuara e kanë ndërmarrë këtë masë në bashkëpunim me aleatët tanë në NATO dhe partnerët tanë kudo në botë, në përgjigje ndaj përdorimit të armëve kimike të nivelit ushtarak nga Rusia në territorin e Mbretërisë së Bashkuar, veprimi më i fundit në vazhdën e veprimeve të saj destabilizuese në mbarë botën".



Deputeti i PD reagon për vendimin e qeverisë shqiptare

## Tritan Shehu: Shqipëria, vend anëtar i NATO-s, e detyruar të solidarizohet

Pas vendimit të qeverisë shqiptare për të dëbuar dy diplomatë ruse në vijim të sanksioneve të marra nga të gjitha vendet e NATO-s pas helmimit të ish-spiunit rus në Britani, gjë për të cilën akuzohet Moska, ka reaguar edhe Partia Demokratike. Deputeti i PD, Tritan Shehu deklaroi se vendimi është një detyrim për Shqipërinë, pasi është anëtare e NAT0-s. "Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe është e detyruar të solidarizohet me vendet e NATO-s, aq më tepër kur cenohet sovraniteti i njërit prej këtyre vendeve, është një detyrë dhe obligim për ne. Ne e kemi deklaruar, që në çështjet e sigurisë ne do të ndjekim vetëm SHBA. Pra, këtu kemi të bëjmë me çështje sigurie dhe qëndrim amerikan dhe një numri të konsiderueshëm vendesh anëtare të NATO-s. Nuk është thjesht dëshirë, por obligim për nivelet e sigurisë, prandaj e konsideroj një hap normal", tha ai. Largimi i dy diplomatëve ruse ngre pyetjen nëse kërcënohet Shqipëria? "Problemet e kërcënimit janë më shumë se për Shqipërinë, diskutohen në bllok për të gjitha vendet e NATO-s dhe derisa merren vendime të tilla, tregon se gjendja është serioze dhe duhet një reagim serioz, për të frenuar çdo element agresiv ndaj bllokut të NATO-s", tha Tritan Shehu në një reagim për "Report TV". "Çështjet nuk shtrohen sa do të ndikojë në janë në bllok dhe zgjidhen në bllok. Rëndësi ka që ne të reagojmë në bllok", u shpreh dje Shehu. Shqipëria shqiptare shpalli sot 'non grata' dy diplomatë ruse. Me vendimin e marrë, Shqipëria iu bashkua vendeve të aleancës së NATO-s, që vendosën sanksionet pas helmimit të ish-spiunit rus në Britani.

"Do t'i përgjigjemi kësaj lëvizjeje jomiqësore nga ky grup vendesh"

## Ministria e Jashtme ruse: Keqardhje, gjesti i BE-SHBA, provokues e i pabazuar

Ambasada ruse në Tiranë ka reaguar pas lajmit se edhe shteti shqiptar do t'i bashkohet BE-së, SHBA-ve dhe Londrës për dëbimin e diplomatëve ruse pas helmimit të ish-agjentit Skripal në Londër. Përmes deklaratës së Ministrisë së Jashtme ruse, ambasada në Tiranë tha se Rusisë i hidhet faji vetëm sepse incidenti nuk ka shpjegim tjetër të besueshëm. Sipas MPJ ruse, kjo është një akuzë e pathemeltë. Po kështu, MPJ ruse shpreh keqardhjen që "Bashkimi Evropian preferoi t'i bashkohej një tjetër fushate antiruse të nisur nga Londra dhe aleatët e saj përtej oqeanit, me një qëllim të qartë për të krijuar edhe një pengesë më shumë në rrugën drejt normalizimit të situatës



në kontinentin evropian. Na krijon keqardhje deklarata për incidentin kimik në Salisbury, e miratuar më 22 mars gjatë mbledhjes së Këshillit Evropian. Formulimi i përdorur nga BE-ja, i cili ia hedh Rusisë përgjegjësinë e ngjarjes vetëm për arsye se 'nuk ka asnjë shpjegim tjetër të besueshëm', përbën në thelb një akuzë të pathemeltë kundër vendit tonë", thuhet në deklaratë. "Shprehim protestën tonë të fortë përballë vendimit të marrë nga disa vende të BE-së dhe NATO-s për të dëbuar diplomatët ruse. Gjesti provokues i të ashtuquajturës solidaritet i këtyre vendeve me Londrën, që në mënyrë qorre ndjek autoritetet britanike në të ashtuquajturën rasti 'Skripal' është një vazhdimësi e politikave konfrontuese për të përshkallëzuar situatën. Duke lëshuar akuza të pabaza kundër Rusisë, në mungesë të shpjegimeve për atë çfarë ndodhi, autoritetet në mënyrë de fakto kanë miratuar një qëndrim të paragjykuar dhe hipokrit. Kjo lëvizje jomiqësore nga ky grup vendesh nuk do të kalojë pa u vënë re dhe ne do të përgjigjemi", deklaron Ministria Jashtme e Rusisë.

## HETIMI
### DROGA

Hetimi parlamentar, PD publikon listën e dëshmitarëve, PS kërkon shtrirje në kohë

# Zbardhet planveprimi për "Tahirin", dy qeveri në hetim për drogën

## Noka: Mos u trembni! Fino: Edhe ti do dëshmosh


Mbledhja e përbashkët e Grupeve Parlamentare PD dhe LSI

Valentina Madani

Komisioni hetimor "Tahiri" miratoi dje rregulloren me dakordësi mes pozitës dhe opozitës, por debati u krijua për planin paraprak të hetimit. Kreu i komisionit, Edi Paloka deklaroi se për veprimtarinë e Sajmir Tahirit në trafikun e drogës do të pyetet kryeministri Rama, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj, ish-ministri Tahiri dhe zyrtarë e ish-zyrtarë të lartë të SHISH e Policisë. Por, ajo që ra në sy është kërkimi i informacionit nga SHISH si dhe thirrja në komision e ish-kreut të këtij institucioni, Visho Ajazi mbi informacionet që u ka përcjellë institucioneve për problemin e kanabisit. "Do të thirren Edi Rama kryeministër, Fatmir Xhafaj ministër i Brendshëm, Saimir Tahiri ish-ministër i Brendshëm, Visho Ajazi Lika ish-drejtor i përgjithshëm i SHISH, Haki Çako ish-drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Helidon Bendo drejtor në detyrë i SHISH", tha z.Paloka. Gjatë mbledhjes së djeshme deputetët e PS-së kërkuan kohë për ta parë planin paraprak të hetimit dhe të shtojnë gjëra të tjera që duhet të hetohen. Dhe si kundërpërgjigje, socialistët duan në komision ish-zyrtarë të lartë, duke e shtrirë hetimin që nga viti 1992, kur demokratët ishin në pushtet. "Zanafilla e kanabisit është sa jeta dhe në Shqipëri ka filluar që në vitin 1992. Prandaj ky është një fenomen që duhet hetuar nga rrënja, sepse në 2014 nuk ka ardhur menjëherë. Duhet ta shtrijmë në kohë hetimin e çështjes së kanabis sativa, sepse duhet të gjejmë dhe zanafillën", - tha socialisti Sterkaj. Por demokrati Flamur Noka deklaroi: "Ky komision me vendim të Kuvendit ka si qëllim për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit të trafikut të lëndëve narkotike, përfshi çështjen Tahiri për të cilin prokuroria po heton. Pra, ka një thelb për të cilën është krijuar. Në rast se doni të krijoni një komision për Flamur Nokën, gati jam ta votojmë, ngriheni komisionin, unë jam i gatshëm ta votoj, të vij këtu dhe të raportoj të jap llogari. Këtë e kemi për çështjen 'Tahiri', kështu që mos u trembni dhe mos hidhni tymnajë andej këtej. Këtu e kemi për tonelatat e drogës, për krimin". Kurse Bashkim Fino u shpreh: "Të jeni të bindur se përveç këtyre emrave që keni vendosur ju këtu, do të shtojmë edhe ne emra, sepse kryeministër në atë kohë ka qenë Sali Berisha, ministër i Brendshëm ka qenë Bujar Nishani, ka qenë Flamur Noka që për mua ka konflikt interesi dhe duhet të ikë nga komisioni". Në planin hetimor parashikohet edhe marrja e të gjithë procedurës për ekstradimin në Itali të shtetasit Nezar Seiti. Socialistët kërkuan një javë kohë për t'u njohur me planin parahetimor dhe për të bërë ndryshime apo shtesa. Një tjetër pikë e debatit ishte votimi, ku demokratët kërkuan votim të fshehtë. Dy relatorët, Enkelejd Alibeaj i PD dhe Klotilda Ferhati nga PS kërkuan që votimi të jetë i fshehtë, por deputetët socialistë Bashkim Fino dhe Paulin Stërkaj dolën kundër, duke kërkuar mbledhje të hapura. Pas diskutimeve mes anëtarëve të komisionit, u arrit në përfundimin që kur e vendos shumica e anëtarëve, votimi do të jetë i fshehtë, në raste të tjera do të jetë i hapur.



Komisioni hetimor "Tahiri"

**MILIONE**

Kreu i komisionit, Edi Paloka deklaroi se për veprimtarinë e Sajmir Tahirit në trafikun e drogës do të pyetet kryeministri Rama, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj, ish-ministri Tahiri dhe zyrtarë e ish-zyrtarë të lartë të SHISH e Policisë. Por, ajo që ra në sy është kërkimi i informacionit nga SHISH si dhe thirrja në komision e ish-kreut të këtij institucioni, Visho Ajazi.

### "Qytetet që kontrollohen nga grupet mafioze"

## Nishani: Më keq se në '97-ën. Kriminelët vendosin për gjithçka

Ish-presidenti Bujar Nishani akuzoi dje se, "qeveria aktuale e ka degraduar imazhin e Shqipërisë në pikën më të ulët që nga ngjarjet e dhunshme të vitit të mbrapshtë 1997". Sipas tij, ligji ka degraduar në katrahurë. Nishani përmendi me radhë qytetet ku sipas tij, kontrollin e kanë grupet mafioze dhe ata vendosin për gjithçka. "Miliarda lekë të denoncuara, zyrtarë të identifikuar, por asnjë hetim nga krimi ekonomik i policisë, asnjë referim prej tyre në prokurori! Pse? Kryeministria dhe Ministria e Brendshme e kanë në dispozicion ligjin dhe procedurën, por e kanë injoruar totalisht atë", tha z.Nishani. Ai përmendi më tej: "Më karikaturë se kaq nuk ka se ku të gjesh model tjetër ligji. Por dukshëm që edhe të gjitha këto nuk po mjaftojnë për të kapur zgjedhjet e radhës, ndaj investimi i pushtetit tashmë është drejtuar tek asgjësimi i opozitës. Paratë e trafikut të drogë janë në dispozicion të kësaj lufte. Njerëzit e korruptuar dhe peng të drejtësisë janë në koalicion. Ligjet kanë degraduar në karikaturë të vetë pushtetit në këtë luftë të pushtetit kundër opozitës. Një luftë krejt e pabarabartë, por që nuk mund të dorëzohet. Për më tepër kur edhe ligji ka degraduar në një karikaturë. Po Evropa, a do të tregohet e butë me këtë luftë në Shqipëri"?



### KORRUPSIONI



## Salianji: Pasuria e Grupit të PS, më shumë se Real Madridi

Drejtori i Parandalimit të Pastrimit të Parave, Arlind Gjokutaj raportoi dje në Komisionin e Sigurisë mbi punën e institucionit që ai drejton për vitin e kaluar. Gjatë vitit 2017, kjo drejtori lëshoi 52 urdhra bllokimi të llogarive bankare me një vlerë totale për 11,2 milionë euro, nga të cilat 9 milionë euro janë sekuestruar. Demokrati Ervin Salianji i kërkoi Drejtorisë së Pastrimit të Parave të hetojnë pasurinë e anëtarëve të grupit socialist, vlera e të cilës siç tha i kalon 400 milionë euro. "Kam parë pasurinë e grupit parlamentar të PS-së dhe në total vlen më shumë se Reali i Madridit, i cili e ka vlerën tek 400 milionë euro. Këta vlejnë më shumë vetëm me pasuritë e deklaruara", tha ai.

### LARGIMET



## Panariti: Lakror "mercenarësh" në tepsinë e Rilindjes

Largimet e LSI-së u vunë re dje edhe në Devoll, ku kryetari i këshillit bashkiak, Albert Lilo, iu bashkua grupit të PS-së. Lëvizjes së Lilos iu bashkuan edhe tre këshilltarë të partive të vogla. Por Edmond Panariti, deputet i LSI në Korçë deklaroi: "Lakror 'mercenarësh' në tepsinë e ndryshkur të Rilindjes! Tre anëtarët e Këshillit Bashkiak të Devollit, përkatësisht përfaqësues të Demokracisë Sociale, Partisë Social Punëtore dhe PDRE largohen nga LSI?! ...Çfarë karagjozllëku! Sa për kryetarin, ai është blerja e radhës me presion vendi pune, me arsyetimin të mbrohemi nga rreziku rus i opozitës. Kur të mbarojë teatri, do t'u japim edhe statistikat".




Mbledhja e grupeve PD-LSI, Basha: Kërkojmë hapjen e negociatave me BE-në

# Opozita e bashkuar: S'ndalemi deri në largimin e Edi Ramës

## Kryemadhi: Gjeneratori që mban me energji krimin

Valentina Madani

Opozita e bashkuar i kërkon Bashkimit Evropian që t'i japë Shqipërisë shansin e hapjes së negociatave, ndërkohë që nuk do të reshtë deri në largimin e kryeministrit Rama si një kërcënim serioz i sigurisë kombëtare. PD dhe LSI mblodhën dje grupet parlamentare në kryesinë e Kuvendit, të cilat do të jenë periodike. Kreu i PD-së, Lulzim Basha tha se opozita kërkon nga BE-ja që t'i japë Shqipërisë dhe shqiptarëve shansin e nisjes zyrtare të negociatave të anëtarësimit, në mënyrë që t'i shpëtojë nga qeveria "Rama", që sipas, tij është një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare dhe atë të vendeve të BE-së, për sa i takon trafikut të drogës, krimit të organizuar dhe "eksportit" të emigrantëve. Sipas Bashës, integrimi evropian i vendit është i kërcënuar, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të vendosura nga KE dhe vendet anëtare. Kushte që sipas kreut të PD-së, nuk po përmbushen si rezultat i rekordeve kriminale korruptive të mazhorancës. Në këtë mënyrë, opozita nisi aksionin e përbashkët kundër qeverisjes së Edi Ramës, që kryetarja e LSI-së e quajti "gjeneratori që mban me energji krimin e organizuar dhe trafikun e drogës". Pas protestës së 27 janarit, aksioni opozitar i nisur nga dje do të ketë të bëjë me koordinimin e të gjitha veprimeve opozitare deri në rrëzimin e Edi Ramës. "Nga kjo ditë e sotme, ashtu siç jemi akorduar me zotin Basha, kjo opozitë e bashkuar do të ketë mbledhjet e saj periodike sa i takon aksionit opozitar në parlament, jo vetëm në komisione dhe në përgatitjen e ligjeve, por në kthimin e një institucioni politik, i cili nuk ka më ndalim deri në largimin përfundimtar të Edi Ramës, i cili nuk është gjë tjetër, veçse gjeneratori që mban me energji krimin e organizuar dhe trafikun e drogës", deklaroi kryetarja e LSI-së. Nga ana e tij, kreu i PD-së, Lulzim Basha u bëri thirrje të gjithëve të bashkohen për të mos e lënë fatin e vendit "në dorë të 10 kriminelëve dhe oligarkëve". "Rama nuk do integrimin e Shqipërisë. Në vend që të luftojë krimin dhe të vërë para drejtësisë Habibajt, Edi Rama përpiqet t'i shpëtojë ata. Vazhdon të ushtrohet presion për të ndaluar, sabotuar hetimet ndaj Saimir Tahirit. Vazhdon presion i jashtëzakonshëm për të mos nisur hetimet ndaj Dakos, Sejdinit. I gjithë pushteti është në dorë të Edi Ramës. Rama kontrollon parlamentin, qeverinë, segmente kryesorë të gjyqësorit, median. Detyra kryesore e opozitës parlamentare është jo vetëm të denoncojë aferat korruptive, por t'i tregojmë shumicës dërrmuese rrugës se si 3 mln shqiptarë nuk do të mbeten peng i 10 qeveritarëve të korruptuar. Nuk ka integrim pa vënë para drejtësisë kryebashkiakët dhe ministrat e korruptuar", tha z.Basha. Kurse Kryemadhi njoftoi se aksioni opozitar është institucionalizuar dhe nuk ka kthim pas. "Nuk ka më kthim pas në rrugën tonë, e cila nuk do të njohë më pengesa përsa i përket narkoqeverisë së Edi Ramës dhe as falangave të krimit të tij, që kanë zaptuar çdo pjesë dhe çdo institucion. Ata që mendat se mitingu i 27 janarit ishte finalja e aksionit opozitar, e kanë menduar tërësisht gabim. Ai miting ishte fillimi i një rruge që nuk ka më kthim pas. Aty ka nisur beteja jonë me qeverinë e Edi Ramës, e narko-shtetit dhe qeveria e krimit nuk mund të mbajë më peng as shqiptarët, as politikën shqiptare dhe as të ardhmen e brezave të shqiptarëve. "Forca jonë janë mbi 1 milion shqiptarë që na votojnë ne së bashku, por edhe 1 milion shqiptarë të cilët duan të kthehen në Shqipëri dhe t'i japin dërmën një orë e më përpara Edi Ramës", u shpreh Kryemadhi.



Kreu i opozitës Lulzim Basha

**AGRON DUKA**
"Është herët për të folur për kandidimin tim 2019-ën. Kam besim në arritjen e një marrëveshjeje produktive me PD dhe PAA do të ketë mundësinë të garoje për një apo dy bashki. Gjithsesi, nuk e përjashtoj si mundësi, sepse do të ishte një krenari konkurrimi me siglën e PAA në Durrës. Deri atëherë do të punojmë për të ngritur infrastrukturën e nevojshme për të përballuar zgjedhjet", tha kreu i PAA.

**SALI BERISHA**
Ish-kryeministri Berisha publikoi dje fakte lidhur me ngarkesën e 613 kg kokaine të kapur në Durrës me klanin Rama. Ai përmendi që nga shkarkimi i drejtorit të Portit, Qirici dhe zëvendësimi i tij me të besuarin e Rames, Afrim Bakaj, te doganierët që kaluan konteinerin.

### Viktimat e komunizmit, mbi 4500 veta pa varre

## Basha, ndjesë demokratëve: Kam reflektuar, të bashkohemi kundër krimit

PD-ja përkujtoi dje të zhdukurit e komunizmit, mbi 4500 vetave nuk u janë gjetur eshtrat. Kreu demokrat, Lulzim Basha, kërkoi ndjesë para demokratëve dhe u zotua që PD do të shembë diktaturën e krimit dhe të luftojë për gjetjen e eshtrave të të rënëve të asaj kohe. Duke hedhur akuza të forta ndaj qeverisë, Basha deklaroi se çështjet e të përndjekurve nuk mund të zgjidhen nga persekutorët Edi Rama, Fatmir Xhafaj e Gramoz Ruçi, apo dhe Rilindja e krimit, por PD është vendi i duhur. Ai u bëri thirrje të gjithë ish-të përndjekurve dhe demokratëve të bashkohen nën siglën e PD për të zgjidhur këto çështje. "Edhe unë kam bërë gabimet e mia, nuk jam i pagabueshëm. Ndaj kërkoj nga ju të më njihni të drejtën që u njoh të gjithë demokratëve, të drejtën për reflektim dhe të reflektojmë së bashku. Eja Tomor, ejani të gjithë ju, le të bashkohemi në gjirin e PD. Është vendi, është institucioni, është garancia e vetme për të drejtat e papërmbushura. Së bashku me ndjesën time të thellë si kryetar i PD dhe me zotimin tim se do të bëjmë gjithçka së bashku për të shembur diktaturën e krimit dhe për të lartësuar sakrificën e paraardhësve tuaj përmes sakrificës tonë dhe luftës pa kompromis për të shembur të keqen dhe për të kthyer vlerat demokratike", theksoi z.Basha. Sipas tij, vendimi kriminal për të hequr dëmshpërblimin për pasardhësit e të persekutuarve. "Kjo mbetet Rilindja e diktaturës, Rilindja e pinjollëve të diktaturës, që nga ylli i kuq në gjoksin e Edi Ramës ka një qëllim të vetëm, fshirjen në çdo kujtesë të krimit. Ne nuk jetojmë më në një vend demokratik, parlamenti shqiptar nuk ka dalë nga vota e lirë e shqiptarëve, por nga paratë e drogës dhe të krimit", u shpreh kreu i PD-së.



**ASTRIT PATOZI**
"Gabimet tona të mëdha kanë sjellë pasoja të rënda për PD, që nga zgjedhjet lokale të vitit 2015 e deri tek marrëveshja e famshme e 18 majit, e cila u pasua me humbjen katastrofike të 25 qershorit", tha Patozi.

## Integrimi, Vlahutin: Negociatat, jo dhuratë. Bushati: Bëmë progres

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian diskutoi dje mbi Strategjinë e Komisionit Europian për zgjerimin në kuadër të procesit hapjes së negociatave, që Shqipëria shpreson që të ndodhë në qershor. Pjesë e takimit ka qenë edhe ambasadorja e BE në Tiranë, Romana Vlahutin, e cila theksoi se negociatat nuk janë një dhuratë, ndërsa kërkoi që të luftohet krimi dhe korrupsioni. "Shteti i së drejtës është një nga pikat kryesore. Strategjia ka si bazë të saj luftën kundër korrupsionit dhe krimit. BE është e vendosur për të rritur angazhimin në rajonin e Ballkanit. BE synon nxitjen e investimeve në rajon dhe mbështetjen në arsim dhe sektorin social, sidomos arsimit profesional. Negociatat nuk janë një dhuratë. Mirëpresim diskutimet nga shoqëria civile për të mbështetur dialogun mbi konsensusin për gjërat më të rëndësishme që kanë të bëjnë me Shqipërinë", tha ambasadorja e BE. Ministri i Jashtëm, Bushati theksoi se situata brenda BE nuk është në favor të Ballkanit, por vendosja e një afati dhe një date në horizont i motivon vendet kandidate. "Situata brenda BE nuk është në favor të Ballkanit, prandaj përshëndesim qasjen e KE në këtë drejtim. Strategjia e zgjerimit të vendeve të BE ofron një horizont të 2025. Pasja e kalendarëve veçse i motivon vendet e Ballkanit për të ecur me reformat", tha ai. Duke u ndalur te negociatat, Bushati tha se Shqipëria pret rekomandimin në prill, ndërsa 2018-ën e cilësoi një vit të artë. "Presim raportin e KE, Shqipëria ka bërë progres, mbetemi me shpresë që në prill komisioni do të rekomandojë nisjen e këtij procesi bazuar mbi logjikën e rekomandimit të 2016-ës. Besojmë që KE do të përshkruajë reformat në dy vitet e fundit. 2018-ta, një dritare e artë", deklaroi Bushati.



## RRUGA E KOMBIT
### TARIFA

Kryeministri Rama: Nuk ka pagesë 10 euro, por është 5 euro, çmim që paguhet kudo në rajon

# Taksa e rrugës, biznesi kundra

## *Bytyçi: Kjo është plaçkitje,Kolgjini: Kuksianët të mos paguajnë*

Elsa Doda

**KOSOVË**

Rreth 50 biznese të ndërtimit nga Kosova kanë vendosur që ta bojkotojnë "Rrugën e Kombit" gjatë ditës së djeshme pas vendimit për vendosjen e tarifës nga qeveria shqiptare për kalimin e autostradës. Tarifa që qeveria ka vendosur mbi këtë rrugë është deri në 4 herë më e lartë se sa çmimi i rekomanduar nga kompania konsulente. Lidhur me këtë çështje ka reaguar dhe kryeministri Edi Rama në rrjetin e tij social, duke iu përgjigjur komentit të një qytetari, se "nuk ka pagesë 10 euro, por është 5 euro, çmim që paguhet kudo në rajon dhe kontribut që shkon për mirëmbajtjen e rrugës, e cila u ndërtua pjesërisht (ndërkohë që kompania do të përfundojë edhe ndërtimin) dhe mbeti në mëshirë të fatit nga pamundësia e mirëmbajtjes që ka një kosto jo të vogël!".

Bojkotimi: Bizneset qe morën pjesë në bojkotimin e rrugës u shprehen se importojnë material ndërtimor nga Shqipëria me vlerë rreth 35 milionë euro në vit dhe "Rrugën e Kombit" e kalojnë në vit rreth 21 mijë makina. Pas vendosjes së taksës, ku taksa për makineri të rënda është 46 euro vajtje-ardhje, kompanitë në vit detyrohen të paguajnë rreth 1 milion euro më shumë. Këto kompani këtë e quajnë si plaçkitje nga qeveria shqiptare. Përfaqësuesi i këtyre bizneseve, Jetmir Bytyçi, deklaroi se kjo është një "plaçkitje" e vendosur nga shteti shqiptar, për të cilin thanë që kanë tentuar t'ia paraqesin ankesat e shqetësimet e tyre, por që nuk u morën parasysh deri tani. "Pas këtij bojkoti, do të detyrohemi që biznesin ta orientojmë nga vendet e "padëshirueshme", siç janë Serbia dhe Maqedonia. Nuk jemi kundër vendimit të taksës rrugore, por çmimit të lartë të saj. Nuk do të heqim dorë nga vendimi për mbajtjen e bojkotit, deri në zbritjen e taksës rrugore"-u shpreh Bytyçi. Bizneset e ndërtimit kërkojnë, gjithashtu, nga qeveria shqiptare që t'i marrë parasysh këto kërkesa, pasi sipas tyre përgjatë 10 viteve kur u ndërtua kjo autostradë, vetëm me këto produkte që tani do t'i bojkotojnë, shuma që Shqipëria përfitoi ishte rreth 350 milionë euro. Ata kanë paralajmëruar edhe protesta në Kosovë e Shqipëri 24 orë para hyrjes në fuqi të taksës rrugore. Kundërshti ndaj vendimit për taksimin e "Rrugës së Kombit" ka pasur edhe nga ana e banorëve dhe bizneseve të Kukësit, të cilët e përdorin më shpesh këtë aks. Sokol Kolgjini, kryetar i Shoqatës "Biznesi për Biznesin" ka kërkuar që banorët e Kukësit të mos paguajnë taksë deri në gjetjen e një rruge alternative. "Është taksë e paligjshme, pasi detyrohen të gjithë shqiptarët, veçanërisht komuniteti kuksian, dy herë për të njëjtin shërbim. Komuniteti të mos paguaj taksë, derisa të ketë një rrugë alternative", u shpreh Kolgjini. Kompania që do të vjelë taksën thotë se do të ketë lehtësira për banorët e zonës dhe mjetet që udhëtojnë më shpesh në këtë rrugë.


Sportele në Rrugën e Kombit

### TAKSA PËR VENDET E RAJONIT

**Maqedoni:** ˙P[lcidhæ˙*(3˙_oli˙',(/'-(/˙_oli

**Turqi:** ˙Ol[˙Moffn[h˙M_fcg˙g\c˙haombnc]æh˙_˙<im`ilcn [jfceib_n˙j[a_mæ˙jæl˙p_nol[n˙+(1˙_oli˙hæ˙^cnæ˙^b_˙jæl e[gcihæn˙,(-˙_oli(

**Moldavi:** ˙P_nol[˙*(/˙_oli

**Francë:** ˙Noh_fc˙Jl[^i'=[l_h[a_4˙,(2'-(,˙_oli

**Francë:** ˙Ol[˙Jihn˙^_˙Nl[h][lpcff_4˙,(0'-(2˙_oli

**Rumania:** ˙.'/˙_oli

**Mali i Zi, tuneli i Sozinës:** ˙,(/˙_oli

### Administratori 'Laçi sh.p.k': Jemi të detyruar

## Taksa e 'Rrugës së Kombit', paralajmërohet rritja e çmimit të biletave

Taksa e vendosur nga qeveria shqiptare për të kaluar në 'Rrugën e Kombit', ka sjellë ndikimin e parë negativ tek qytetarët. Brenda pak ditësh kjo taksë do të aplikohet në mjetet që lëvizin nga Kosova e Kukësi drejt Tiranës, e cila do të çojë në rritjen e çmimit të biletës së udhëtimit. Shoqëria që merret me transportin e udhëtarëve nga Kukësi në Tiranë dhe anasjelltas ka deklaruar se do të rrisë çmimin e biletës për të gjithë udhëtarët. Administratori i shoqërisë 'Laçi sh.p.k' deklaroi se është i detyruar të rrisë çmimin e biletës, por nuk bëri me dije se sa do të jetë çmimi i ri. "Do ta rrisim biletën. Kur të vendoset pagesa e rrugës, do të rritet edhe çmimi i biletës së udhëtimit nga Kukësi në Tiranë",- është shprehur administratori i shoqërisë. Vendosja e taksës së re në rrugën që u ndërtua për të ndërlidhur Shqipërinë dhe Kosovën ka shkaktuar reagime në të dyja vendet. Aktualisht çmimet Tiranë-Prishtine janë: 10 euro (vajtje), 20 euro (vajtje–ardhje); Tiranë-Gjakovë 15 euro (vajtje) 20 euro (vajtje-ardhje); Tiranë-Pejë, 15 euro (vajtje), 20 euro (vajtje-ardhje); Tiranë-Prizren 10 euro (vajtje) e 15 euro (vajtje-ardhje). Ndërkohë, Tiranë-Kukës me autobus 400 lekë të reja (vajtje), me fugon 600 lekë të reja (vajtje).


Autostrada Durrës Morinë



**ENNO BOZDO**

"Ajo që po ndodh sot është e pavend, jo thjeshtë për ngarkesën ekonomike , por edhe për faktin që qeveria këtë shumë e ka mbledhur në mënyra të ndryshme," është shprehur gjatë ditës se djeshme lidhur me çështjen e taksës në 'Rrugën e Kombit', sekretari organizativ në PD, Enno Bozdo. Gjithashtu, Bozdo u shpreh se tarifimi është shumë i lartë. "Kjo është një taksë që do rëndojë banorët që udhëtojnë, por do ketë ndikim edhe në tregtinë mes dy vendeve.



**PETRIT VASILI**

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili ka folur gjatë ditës së djeshme për vendimin e qeverisë në lidhje me vendosjen e taksës në "Rrugën e Kombit". Vasili ka shprehur reagimin e tij kundër, duke thënë se taksa është shpenzim i ri për shqiptarët. "Për këtë rrugë shqiptarët po paguajnë ende borxhin që është marrë për ndërtimin e saj, ndërsa taksa shtesë është shpenzim për qytetarët që nuk kanë të njëjtin nivel të ardhurash me qytetarët e BE",-u shpreh ai.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTORES LITIUM" (EXC LIT) sh.p.k

Shoqëria Përmbarimore "Executores Litium " sh.p.k
do të zhvillojë ankandin e pare për pasuritë e paluajtshme :
Truall me nr.pasurie 45/8, me sip. 4392 m2, ZK 1006, vol 01, fq.197, e ndodhur ne Ahmetaq Tirane ,ne pronesi te Petrit Shefqet Elezi.
*Cmimi me te cilin do te filloje ankandi eshte ne vleren 119,008 Euro*
Ndertese me nr. pasurie N/45/8, me sip. 1167 m2, ZK 1006, vol 9, fq.197, e ndodhur ne Ahmetaq Tirane ,ne pronesi te Petrit Shefqet Elezi, Altin Dervishi, Ermir Stafa.
*Cmimi me te cilin do te filloje ankandi eshte ne vleren 208,512 Euro*
Ankandi do të zhvillohet në datë 06.04.2018 ora 16:00, në zyrën përmbarimore "Executores Litium" sh.p.k, me adresë *Blv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tirane*.

Pas pezullimit, nis kontrolli i akteve të marrjes së tokës, nuk cenohen pronarët e ligjshëm

# Ligji 7501, Etilda Gjonaj: Verifikim të titujve të pronësisë

## *Ministrja e Drejtësisë: Kemi nisur reformën e pronave*

Ornela Manjani

Të gjitha aktet e marrjes së tokës në pronësi do të kalojnë në "sitë". Vendimi i Këshillit të Ministrave për pezullimin e përkohshëm të regjistrimit të titujve të pronësisë, për ministren e Drejtësisë, Etilda Gjonaj është fillimi i një reforme të thellë në sektorin e pronave. Gjonaj garantoi se nga ky vendim nuk do të cenohet e drejta e pronarëve të ligjshëm. "Dëshiroj të siguroj të gjithë pronarët e ligjshëm të tokave në bregdet për pacenueshmërinë e të drejtave e tyre të pronësisë dhe të adresojë shqetësimet e tyre lidhur me këtë vendimmarrje. Ky vendim i qeverisë synon që të bllokojë të gjithë ata që kanë abuzuar me pronat dhe i kanë tjetërsuar ato në mënyrë të paligjshme, por në asnjë mënyrë nuk preket e drejta e ligjshme e pronarëve", - tha ministrja. Gjonaj tha se ky vendim u mor nga qeveria pas rasteve të shumta të abuzimeve me pronat në bregdet, që janë bërë publike kohët e fundit. "Vendimi i Këshillit të Ministrave për pezullimin e përkohshme të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore, të ish-ndërmarrjeve bujqësorë dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi ka ardhur si pasojë e një situate të jashtëzakonshme abuzimesh në bregdet. Janë ndarë duke u konsideruar si toka bujqësore, zona e rërës së plazheve, zona e bregut pyjor të plazheve, janë ndarë kënetat, janë ndarë ligatinat dhe moçalet e ultësirës. Janë ndërruar zërat e kadastrave, duke kthyer tokat e pafrytshme në toka bujqësore", - tha ministrja. Sipas ministres së Drejtësisë, do të bllokohen të gjithë ata që kanë abuzuar me pronat. "Vendimi i Këshillit të Ministrave 'Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike' ka ardhur si pasojë e një situate të jashtëzakonshme abuzimesh në bregdet, me procesin e ndarjes dhe regjistrimit të tokës në fshat, ose siç quhet ndryshe, me pajisjen me AMTP (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi). Ky proces i nisur që në vitin 1991 me Ligjin 7501, që kishte si qëllim të vetin ndarjen e tokës së ish-kooperativave bujqësore, anëtarëve të familjeve bujqësore, rezultoi në shumë raste në abuzime nga funksionarë shtetërorë, komisione fshatrash, kryetarë komunash etj., me qëllime përfitimi", - tha ministrja.



Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

**ARSYEJA**

"Reforma e pronës do të jetë e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllimin për të zgjidhur njëherë e mirë çështjen e pronës dhe për t'i dhënë rrugë zhvillimit ekonomik dhe turistik të vendit. Kaosi i pronave, që është shkaktuar në 25 vjet do të mbetet në historinë e shtetit modern shqiptar si pengesa më e madhe në procesin e ngritjes së ekonomisë së qëndrueshme.

**VENDIMI**

Vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon pezullimin e lëshimit dhe regjistrimit të AMTP-ve në hipotekë, deri në verifikimin e titujve të lëshuar. "Ky vendim, në asnjë mënyrë nuk ka si qëllim të bllokojë pronarët e ligjshëm, por vetëm grabitësit e tokës dhe abuzuesit e ligjit. Rëra dhe plazhet, që janë kthyer si tokë bujqësore në shkelje të ligjit nuk mund të regjistrohen dhe të legjitimohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme", - tha ministrja. Sipas saj, vendimi për pezullimin e regjistrimit të AMTP-ve synon të garantojë që prona t'i kthehet pronarit dhe jo shkelësve të ligjit dhe mafies së pronave. "Vendimi i qeverisë për skanimin e pronave në vijën bregdetare është një vendim në mbrojtje të interesit publik dhe të interesave të pronarëve të ligjshëm, kundër akteve të shumta kriminale ndaj pronës shtetërore dhe private. Pezullimi është veç një masë e përkohshme që do t'u lejojë institucioneve të shtetit të verifikojnë në mënyrë prioritare titujt e lëshuar përgjatë bregdetit dhe të ndajnë një herë e mirë pronarët e ligjshëm nga hajdutët e pronave", - tha ministrja.

**REFORMA**

Ministria e Drejtësisë ka nisur punën për reformën e pronës, në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë. "Reforma e pronës do të jetë e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëlli-min për të zgjidhur njëherë e mirë çështjen e pronës dhe për t'i dhënë rrugë zhvillimit ekonomik dhe turistik të vendit. Kaosi i pronave, që është shkaktuar në 25 vjet do të mbetet në historinë e shtetit modern shqiptar si pengesa më e madhe në procesin e ngritjes së ekonomisë së qëndrueshme. Në mandatin aktual qeveria synon që përmes reformës së tokës dhe reformës së pronës t'i japë fund këtij kapitulli të stërzgjatur. Vendimmarrjet e mësipërme të qeverisë duhen parë pikërisht në kuadër të këtyre reformave të rëndësishme, të domosdoshme dhe të mirëpritura nga i gjithë opinioni i shëndoshë i vendit", - tha ministrja.

### Fondi 20 mln lekë i hiqet Bujqësisë, i kalon Mbrojtjes

Këshilli i Ministrave ka vendosur të rialokojë një fond 20 milionë lekësh, të cilat do të përdoren për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në zonat e përmbytura në Shkodër. Referuar vendimit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në programin buxhetor "Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor e blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun", artikulli "Transfertë në buxhetet familjare"), zëri "Shpenzime korrente", i pakësohet fondi prej 20 milionë lekësh. Ndërkohë, Ministrisë së Mbrojtjes, në programin buxhetor "Mbështetja e luftimit", i shtohet fondi i përmendur në shkronjën "a", të këtij pike, për t'u përdorur për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në zonat e përmbytura në Shkodër.



### AKEP vendos rregulla të reja

## Portimi i numrit, brenda 24 orëve që është kryer kërkesa

AKEP vendosi dje afatin e ri për portabilitetin e numrit. Afati për realizimin e portimit do të jetë 24 orë nga kërkesa pajtimtarit, ose nga hedhja në sistem e kërkesës nga operatori marrës, krahasuar me 3 ditë pune që është aktualisht. Për numrat celularë operatori marrës do të njoftojë me SMS pajtimtarin për kohën e hedhjes në sistem të kërkesës së tij, e cila në çdo rast nuk duhet të jetë më vonë se 24 orë apo një ditë pune nga depozitimi i kërkesës nga pajtimtari tek operatori marrës. Numri personal i identifikimit do të jetë kriteri kryesor i identifikimit të pajtimtarit për procesin e portimit. Ky është numri unik që gjendet në të gjitha dokumentet e identifikimit të shtetasve shqiptarë si karta e identitetit, pasaporta apo dhe certifikata e lindjes dhe nuk ndryshon gjatë gjithë jetës. Përdorimi i këtij numri pritet të sjellë lehtësira në procesin e identifikimit dhe të shmangë problemet kur pajtimtari është regjistruar me mjet tjetër identifikimi tek operatori dhënës dhe me një mjet të ri identifikimi tek operatori marrës, pasi numri personal nuk ndryshon, pavarësisht ndryshimit të mjetit të identifikimit. Numri unik personal ka përdorim të gjerë edhe në vende të tjera për procesin e portabilitetit si dhe nga Qeveria e RSH për shërbimet ICT dhe 'e-government'.

### AMF, takim me misionin e Bankës Botërore

## Prioritet, projekti për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse

Ecuria e projektit për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me fokus tregun e kapitaleve ka qenë edhe një nga çështjet kryesore të diskutimit gjatë takimit të drejtorit të AMF-së, Ervin Koçi me përfaqësuesit e misionit të Bankës Botërore. Projekti në fjalë është financuar nga Sekretariati Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO), me asistencën e Bankës Botërore. Drejtori i AMF-së, Koçi njohu përfaqësuesit e BB-së me punën e zhvilluar në lidhje me projektligjin për titujt dhe atë për fondet e investimit, si dhe me miratimin e disa rregulloreve për një mbikëqyrje sa më efektive të tregut të kapitaleve dhe mbrojtjen e investitorëve. Ndërkohë, përfaqësuesit e BB u shprehën të kënaqur me ecurinë e projektit dhe rezultatet e arritura deri më tani për rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse. Mundësitë e thellimit të bashkëpunimit përmes një projekti të ri për zhvillimin e tregjeve dhe mbikëqyrjes efektive të tyre ishte edhe një tjetër çështje mbi të cilat diskutuan palë gjatë këtij takimi.



Takimi i AMF me Bankën Botërore

VETINGU

HETIMET

Organi i akuzës kërkon informacion nga ILDKPI, institucione të tjera dhe zyrat noteriale

# Prokuroria e Durrësit nis hetimin ndaj Llallës

## *Ish-kryeprokurori para drejtësisë për pastrim parash*

Ina Allkanjari

Prokuroria e Durrësit konfirmoi zyrtarisht ditën e djeshme se ndaj ish-kryeprokurorit, Adriatik Llallës, është çelur hetimi për "pastrim parash". Siç e parashikon ligji, hetimi do të kryhet në Durrës, pasi është qyteti më i afërt ku punoi ish-kryeprokurori. Në kuadër të këtij hetimi, drejtuesja e caktuar e kësaj prokurorie, Donika Prela ka kërkuar informacion nga disa institucione, konkretisht pranë ILDKPI si dhe në të gjitha zyrat noteriale në vend me qëllim sekuestrimin e kontratave të shitblerjeve të çdo pasurie, përgjatë kohës që Adriatik Llalla ka ushtruar detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm. Në shkurt, Llalla nuk iu nënshtrua vetingut pasi hoqi dorë nga e drejta për emërim në Gjykatën e Apelit. Duke e konsideruar dorëheqjen si të vetmen mënyrë të ndërprerjes së vetingut, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shtoi se Adriatik Llalla për 15 vitet e ardhshme humbet të drejtën për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë. Në këto kushte, trupa gjykuese me kryesues Roland Ilian, vendosi të ndërpresë procesin e rivlerësimit për këtë subjekt, emri i të cilit renditej në listën prej 57 gjykatësish e prokurorësh, të cilët po i nënshtroheshin vetingut. Ndërkohë KPK hetoi për 5 muaj rreth Llallës, dhe të gjitha informacionet e mbledhura rreth tij, do të duhet t'i dorëzojë tek grupi i hetimit. Ish-kryeprokurori i përgjithshëm po hetohet për pastrim të produkteve të veprës penale i kryer nëpërmjet këmbimit ose transferimit të pasurisë, që dihet se është produkt i veprës penale, për fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale; fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes së pronësisë ose të të drejtave të tjera, që lidhen me pasurinë që është produkt i veprës penale; kryerjes së veprimeve financiare dhe transanksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas ligjit për pastrimin e parave; këshillimit, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; përdorimit dhe investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave ose sendeve, që janë produkte të veprave penale, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 5 milionë lekë. Ndërkohë Departamenti Amerikan i Shtetit i ka ndaluar hyrjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla. Vendimi është publikuar në faqen zyrtare të DASH, ndërsa masa e ndalimit është miratuar nga Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson, pasi ish-zyrtari i lartë i organit të Akuzës në Shqipëri akuzohet për përfshirje në raste të mëdha korrupsioni. Sakaq dy ditë më parë media gjermane DW, deklaroi se drejtësia po tregon se po vepron në bazë të provave dhe fakteve dhe rasti më domethënës është ai i ish- Prokurorit të Përgjithshëm Adriatik Llalla. "Hetimi ndaj ish-Prokurorit të Përgjithshëm, Adriatik Llalla është një sinjal se për kulturën e pandëshkueshmërisë, të betonizuar në Shqipëri prej më shumë se dy dekadash, po fillon procesi i ?montimit", shkruante Deutsche Welle.



Ish-kryeprokurori, Adriatik Llalla

**DORËHEQJA**

Në shkurt, Adriatik Llalla nuk iu nënshtrua vetingut pasi hoqi dorë nga e drejta për emërim në Gjykatën e Apelit. Duke e konsideruar dorëheqjen si të vetmen mënyrë të ndërprerjes së vetingut, KPK shtoi se Llalla për 15 vitet e ardhshme humbet të drejtën për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë.

**AMBASADORI LU**

Pas lajmit se Adriatik Llalla, ish-Prokurori i Përgjithshëm është tërhequr nga sistemi gjyqësor, ka ardhur edhe reagimi i ambasadorit amerikan në Tiranë, Donald Lu. Ambasadori e quan fitore tërheqjen e gjykatësve apo prokurorëve të korruptuar, por vë në dukje se kjo nuk ka për t'i shpëtuar nga ndjekja penale.

**SHBA**

Departamenti Amerikan i Shtetit i ka ndaluar hyrjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla. Masa e ndalimit është miratuar nga Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson, pasi ish-zyrtari i lartë i organit të akuzës në Shqipëri akuzohet për përfshirje në raste të mëdha korrupsioni.

Ish-gjyqtari paraqiti arsye personale për largimin nga detyra

# U dorëhoq për t'i shpëtuar vetingut, nis hetimi ndaj Besnik Imeraj

Prokuroria e Tiranës ka nisur ditën e djeshme hetimin ndaj ish-gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, Besnik Imeraj. Dosja e Imerajt është regjistruar në prokurori dhe do të shqyrtohet nga prokurori Ndini Tavani, për të parë nëse ka elementë të veprës penale. Hetimi ka nisur pas kallëzimit të bërë nga KPK ndaj gjyqtarit Imeraj, i cili dha dorëheqjen në janar të këtij viti për të mos kaluar në 'sitën' e vetingut. KPK dorëzoi pak ditë më parë në prokurori gjithë dokumentacionin që rezultoi nga hetimi administrativ gjatë procesit të rivlerësimit. Gjyqtari në dorëheqjen e dhënë ka paraqitur arsye personale për largimin nga detyra. Më herët ish-anëtari i Gjykatës Kushtetuese, ka reaguar ne lidhje me dërgimin e dosjes në prokurori. Ai tha se ky kallëzim është i pabazuar në ligj dhe kushtetutë dhe ka motive politike. "Kjo që po ndodh nuk ka asnjë bazë kushtetuese dhe ligjore. Që kur Edi Rama dhe qeveria bëjnë kontrollin e gjyqtarëve, çdo gjë është e qartë. Unë jam në rregull dhe nuk kam asnjë problem me ligjin dhe Kushtetutën. Kjo e gjitha është e motivuar politikisht",-u shpreh Besnik Imeraj. Ai u dekretua si anëtar i Gjykatës Kushtetuese nga ish-Presidenti Bujar Nishani në 22 mars të vitit 2013. Imeraj është një gjykatës që ka pasur në dorë çështje të bujshme të politikës shqiptare, ishte, gjithashtu, njëri prej gjykatësve që votoi pro shfuqizimit të ligjit të vetingut, ndërkohë që Komisioni i Venecias kishte dhënë miratimin. Ai ishte zgjedhur së fundmi pjesë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, institucion i ri i krijuar si rezultat i reformës në drejtësi.



Besnik Imeraj

**TË ARDHURAT**

- Të ardhura nga paga neto si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, 1 896 470 lekë
- Vajza, Marsela Imeraj, të ardhura nga paga si avokate, 1 207 780 lekë.
- Gjendja në llogarinë e pagës, në një bankë të nivelit të dytë, 80 000 lekë.
- Gjendja në llogarinë e pagës, në një bankë të nivelit të dytë, 700 000 lekë.
- Depozita në emër të vajzës, në një bankë të nivelit të dytë, 920 462 lekë.

Vrau bashkëshorten, delegohet në Shkodër çështja për Sadedin Sula

# Gjykata e Krimeve të Rënda shpall moskompetencë për 30 dosje

## *Nis nga e para gjykimi për masakrën te "Zogu i I"*

Ina Allkanjari

Gjykata e Krimeve të Rënda pritet të shpallë moskompetencë për 30 dosje, të cilat i ka në gjykim. Kjo, pas vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili i jep përkohësisht kompetencat e Gjykatës Speciale Antikorrupsion. Ditën e djeshme Krimet e Rënda kanë shpallur moskomptencën për vrasjen e trefishtë të ndodhur në bulevardin "Zogu I" në Tiranë tre vite më parë. Pas këtij vendimi çështja është rikthyer në Gjykatën e Tiranës ku do të nisë nga e para. Bëhet fjalë për konfliktin me armë ku mbetën të vdekur shtetasit Mentor Lufi (Doçi), Gerti Goxhaj dhe Besnik Sulku. Të akuzuarit për këtë ngjarje janë dy vëllezërit Markeljan dhe Klevi Doçi, dhe një shtetas italian Salvatore Letizia. Ndërkohë ditën e djeshme Krimet e Rënda shpallën moskompetencën edhe për çështjen e Sadedin Sula, duke e referuar në gjykatën e Shkodrës. Sula akuzohet se urdhëroi vrasjen e bashkëshortes së tij Suela Sula, në prill në 2016. Gjithashtu, ditën e djeshme gjykata e Durrësit ka shpallur moskompetencën dhe ka dërguar te Krimet e Rënda në Tiranë, aksidenti tragjik të Qerretit, të ndodhur në maj të 2016-ës ku humbi jetën Aliçe, 3 vjeç, dhe vëllai i saj Dritani, 5 vjeç.

### MASAKRA TE "ZOGU I I"

Pasditen e datës 27 maj 2015, Mentor Lufi, dy nipat e tij Markeljan e Klevi Doçi, si edhe miku i tyre, Gerti Goxhaj, gjendeshin në një lokal pranë Fakultetit të Shkencave, në bulevardin "Zogu i Parë" në Tiranë.

Pasi janë ngritur nga lokali, ata kanë hipur në dy mjete dhe konkretisht: Mentor Lufi ishte pasagjer në mjetin e drejtuar nga Gerti Goxhaj; ndërsa vëllezërit Markeljan dhe Klevi Doçi gjendeshin në një automjet pas të parit, ku në timon ishte Markeljani. Sapo kanë hipur në automjete, në dy pjesët anësore të makinës së parë, janë afruar dy persona të armatosur, të cilët kanë qëlluar personat që gjendeshin në bordin e saj, konkretisht Mentor Lufin (Doçi) dhe Gert Goxhaj. Nga goditjet me armë ka vdekur në vend Goxhaj dhe është plagosur rëndë Lufi, i cili vdiq pak çaste më vonë. Në momentin e goditjes me armë, Markeljan Doçi afron me shpejtësi makinën drejt atentatorëve, duke përplasur fillimisht njërin prej tyre. Ky i fundit, i cili më pas rezultoi se ishte Besnik Sulku, ka qëlluar me pistoletë në drejtim të mjetit të dytë, por pa u shkaktuar dëme tek vëllezërit Markeljan dhe Klevi Doçi. Të gjendur nën goditjen e armës tip pistoletë nga ana e Besnik Sulkut, Markeljani, gjithashtu, i armatosur me pistoletë, ka reaguar duke qëlluar me armë. Markeljani dhe



Masakra në bulevardin "Zogu I"

**NGJARJET PËR TË CILAT KA SHPALLUR MOSKOMPETENCË GJYKATA**

**1-** Vrasjen e trefishtë të ndodhur në bulevardin "Zogu I" në Tiranë në 27 maj 2015. Bëhet fjalë për konfliktin me armë ku mbetën të vdekur shtetasit Mentor Lufi (Doçi), Gerti Goxhaj dhe Besnik Sulku.

**2-** Vrasja e Suela Sulës në tualetin e mobilerisë në prill të 2016 nga bashkëshorti i saj Sabedin Sula. Ky i fundit akuzohet si personi që urdhëroi ekzekutimin e së resë.

**3-** Aksidenti tragjik i Qerretit, i ndodhur në maj të 2016-ës ku humbi jetën Aliçe, 3 vjeç, dhe vëllai i saj Dritani, 5 vjeç.

Sulku kanë vijuar të qëllojnë njëri-tjetrin, derisa Besnik Sulku ka mbetur i vdekur, pak metra larg nga automjetet. Menjëherë pas ngjarjes, forcat e policisë organizuan operacionin për arrestimin e personave të përfshirë. Fillimisht, në vendngjarje u arrestuan vëllezërit Markeljan dhe Klevi Doçi. Më vonë, pranë një hoteli në atë zonë, u arrestua edhe shtetasi italian, Salvatore Letizia, i cili rezulton se është personi që, së bashku me Besnik Sulkun, ishte pjesë e vrasjes së shtetasve Mentor Lufi dhe Gerti Goxhaj.

### VRASJA E SUELA SULËS

Gjykata e Krimeve të Rënda ka shpallur moskompetencën për Sadedin Sula, duke e referuar çeshtjen në gjykatën e Shkodrës.

47-vjeçari urdhëroi vrasjen e bashkëshortes së tij Suela Sula, në prill në 2016. Për këtë ngjarje, prokuroria e krimeve të rënda, kishte caktuar më herët masën e sigurisë "arrest me burg", edhe për Fatjon Karmeshtnën, i cili akuzohet se ka mbytur me thonj viktimën, në tualetin e mobilerisë. Ditën e djeshme pritej që prokurori i çështjes Enrik Ligori, të jepte pretencën, por gjykata e delegoi dosjen për në Shkodër. Sadetin Sula ka njoftuar vetë policinë për vdekjen e bashkëshortes së tij, Suela Sula. Fillimisht ka njoftuar nipin e tij dhe menjëherë më pas policinë e Shkodrës, duke i thënë se bashkëshortja e tij është vetëvrarë dhe se është në tualetin e mobilierisë e pajetë. Menjëherë forcat e policisë kanë mbërritur në vendngjarje dhe pasi kanë parë rrethanat dhe shenjat në qafë, sy dhe dorën e majtë kanë bërë shoqërimin në polici të bashkëshortit të saj. Mësohet se 47-vjeçari nuk ka pranuar se është autor i vrasjes së bashkëshortes së tij, duke i thënë policisë së ajo është vetëvrarë duke mbytur veten me litar dhe se shenjat në trup kanë qenë si shkak i tentativave për t'u vetëvrarë.

### AKSIDENTI ME 2 FËMIJË TË VDEKUR

Aksidenti tragjik i Qerretit i ndodhur në maj të vitit 2016, ku humbi jetën Aliçe, 3 vjeç, dhe vëllai i saj Dritani, 5 vjeç, vazhdon të konsiderohet një histori e pambyllur për prokurorinë. Për këtë çështje organi i akuzës më herët ka dërguar si të pandehur 4 kolaudues të rrugës Durrës-Kavajë. Ndërkohë ditën e djeshme gjykata e Durrësit ka shpallur moskompetencën dhe ka dërguar pjesën e dytë të kësaj dosjeje për hetime të mëtejshme te Krimet e Rënda në Tiranë. Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas burimeve të sigurta të Top Channel, ka regjistruar çështjen për dyshimet e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, përderisa aksi pranë një pike karburanti u certifikua si i kalueshëm nga Autoriteti Rrugor. Kjo gjë ndodhi atëherë, kur në të vërtetë në këtë rrugë mbrojtëset anësore metalike nuk ishin të standardizuara dhe nuk ishte mbyllur hapësira lidhëse me një pikë karburanti. Në dosjen e parë, prokuroria deklaroi se dy fëmijët, të cilët po udhëtonin së bashku me të ëmën për të takuar babain në burg, u vranë për faj të kushteve të rrugës dhe jo për shkak të mbishpejtësisë. Prokuroria konstatoi asokohe se, nëna e dy fëmijëve, e cila mbeti e plagosur, nuk kishte shkelur asnjë rregull të Qarkullimit Rrugor, por se aksidenti i Qerretit ndodhi pasi autoritetet shtetërore kishin lejuar që ky aks të përdorej jashtë çdo kushti të sigurisë për jetën.

## SHKURT

### Tentoi t'i grabisnin banesën të moshuarit grek, plagoset shqiptari

**GREQI**- Një ngjarje e rëndë është regjistruar ditën e djeshme në Glifadha të Athinës, ku një i moshuar grek ka qëlluar me armë në drejtim të dy hajdutëve shqiptarë. Nga të dhënat që transmetojnë mediat greke, thuhet se njëri prej shqiptarëve ka mbetur i plagosur. Po ashtu bëhet e ditur se nën kërcënimin e armëve, shqiptarët i kanë bërë presion 88-vjeçarit në rrugë, dhe më pas e detyruan që të hynin bashkë në shtëpi. Pavarësisht qëllimit të tyre për të vjedhur, 88-vjeçari ka gjetur mënyrën që të marrë një armë në shtëpinë e tij dhe më pas të qëllojë në drejtim të tyre. Fill pas ngjarjes dy autorët u arrestuan, ndërkohë që njëri prej tyre u dërgua në spital.

### Merr flakë magazina, digjet i gjallë në Greqi 45-vjeçari shqiptar

**GREQI**- Në një aksident të rendë gjatë punës, në Alikes, në Volos të Greqisë, humbi jetën ditën e djeshme një 45-vjeçar shqiptar. Viktima punonte si saldator sëbashku me dy persona të tjerë në depot e kompanisë se frigoriferëve "Aleksopulu" është djegur në zjarrin e madh që përfshiu papritur ndërtesën. Ngjarja e rëndë ndodhi sot në mesditë. Sipas hetimeve të para, gjatë saldimit morën flakë muret e frigoriferëve të vjetër, duke u përhapur menjëherë në gjithë ndërtesën. Ndërsa dy punëtorët e tjerë arritën të largohen, 45-vjeçari nga Shqipëria u gjend i djegur nga zjarrfikësit pranë shkallës së brendshme. Për shuarjen e zjarrit janë dashur 18 makina dhe 44 zjarrfikës, ndërkohë demet janë shume të mëdha, pasi flaka lëshoi dhe helme toksike, të cilat mund dhe të jenë arsyeja që viktima nuk arriti të largohet në kohë.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin per shitjen e pasurise se paluajtshme "Apartamenti" me Nr. Pasurie 4/7+1-7, Zona Kadastrale 8210, Vol.4, Faqe 169, me sip. 63 m², te ndodhur ne Tirane, Rr.Kongresi i Permetit, Pall.85, Shk.1, Ap.7, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditores Valbona Jantili, ne shumen 3'156'480 (tre milion e njeqind e pesedhjete e gjashte mije e katerqind e tetedhjete) leke.
Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është ne shumen 6'480'000 (gjashte milion e katerqind e tetedhjete mije) leke, e percaktuar ne vendimin gjyqesor.
**Ankandi zhvillohet ne date 11.04.2018, ora 16.00 ne zyren e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Toptani, Qendra Torre Drin, Kt.2, Nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471,0684054605, email : ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.**

*United Nations Development Programme*

UNDP

**TENDER ANNOUNCEMENT**

**Subject: ITB – RECONSTRUCTION OF DEVELOPMENT CENTRE, VLORE MUNICIPALITY**

The United Nations Development Programme System in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope and with clearly marked **"ITB – RECONSTRUCTION OF DEVELOPMENT CENTRE, VLORE MUNICIPALITY"** to the address below.

**For more details please refer to the link below:**

http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/ or
http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=45058

**Relevant Dates:** All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 10 April 2018, at 14:00 o'clock.

**Address for Communication and offers' submission:**

**E-mail: procurement.al@undp.org**
**Str. "Skenderbej», Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor,**
**Tirana, Albania**
**Fax: + (355) 4 2250286**
**E-mail: procurement.al@undp.org**

I plagosuri në spital, përfaqësohet në seancën gjyqësore nga avokati

# Tentativa e grabitjes në Fier, gjykata lë në burg Arben Muçën

## 35-vjeçari: Nuk mbaj mend asgjë, jam i tronditur!

**FIER**

Gjykata e rrethit të Fierit dje vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Arben Muçës, i cili mbeti i plagosur nga policia gjatë tentativës së grabitjes së banesës së Minella Muçit. Ngjarje kjo e ndodhur në orët e para të mëngjesit të së premtes në lagjen "29 Nëntori" të këtij qyteti, ku gjatë shkëmbimit të zjarrit mbeti i vrarë 20-vjeçari nga Elbasani, Xhuljan Sollaku. Për shkak të gjendjes shëndetësore, 35-vjeçari me origjinë nga Puka nuk është paraqitur në seancën gjyqësore, por është përfaqësuar nga avokati i caktuar kryesisht nga gjykata, Ardian Abazi. Trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtarja Igerta Hysi vendosi brenda pak minu-tash lënien në qeli të Arben Muçës, ashtu sikurse kërkoi prokurori i çështjes, Çlirim Sina. Gjatë fjalës së tij, avokati Abazi tha se klienti i tij nuk mbante mend asgjë. "Nuk mbaj mend asgjë, jam i shokuar" i ka thënë 33-vjeçari avokatit mbrojtës. Muço nuk ka bashkëpunuar me drejtësinë, e cila po kërkon dy autorët e tjerë të tentativës së grabitjes. Policia mendon se ky është grupi që ka kryer një sërë grabitjesh kohët e fundit në qytete të ndryshme të vendit. Burime nga policia bënë me dije se bëhet fjalë për një grup të sofistikuar kriminal. "Shëtitës", profesionistë dhe të dhunshëm. Ky është përshkrimi, që hetuesit kanë për grupin e grabitësve, i cili në orët e para të mëngjesit të së premtes shkëmbeu zjarr për afro 15 minuta me policinë në lagjen "29 Nëntori" të qytetit të Fierit. Sipas hetuesve të çështjes, ka të dhëna se ky është grup që ka kryer një sërë grabitjesh me armë kohët e fundit në qytete të ndryshme të vendit. Dhe në çdo grabitje policia nuk ka gjetur asnjë gjurmë, që mund të çonte në identifikimin e tyre. Ndërkaq, mësohet se familja Muçi ka një djalë që jeton prej vitesh në Meksikë. Pikërisht ky fakt dyshohet se ka shtyrë grabitësit të tentonin të hynin në banesë, pasi kanë pasur informacione se dy pensionistët mund të kishin para kesh në shtëpi. Bëhet fjalë për rreth një milion euro. Hetuesit besojnë se grabitësit e kanë vëzhguar prej kohësh familjen Muçi. I arrestuari i vetëm i ngjarjes së rendë, Arben Muça (u plagos në këmbë) nuk ka pranuar të bashkëpunojë me policinë. 35-vjeçari është marrë në pyetje në spitalin e Fierit, por nuk ka dhënë asnjë detaj të vlefshëm që mund të çojë në arrestimin e dy personave të tjerë, që morën pjesë në grabitje. Ndërsa, vijon të jetë në kërkim vëllai i tij, Ardi Muça dhe një person tjetër, i cili dyshohet se është nga Fieri dhe njohës i mirë i lagjes "29 Nëntori" ku ndodhi ngjarja.


I arrestuari Arben Muça


Viktima Xhuljan Sollaku




The European Union Delegation to Albania is looking for

ADMINISTRATIVE ASSISTANT

With main focus on

*Human Resources Management and Protocol Issues*

We offer

- *Multicultural working environment*
- *Competitive salary*
- *Benefits by law*

For complete information and application, please refer to:
https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en
"Jobs & Funds" > "Jobs, Internships" > "Job offers"

Deadline for applications: 31/03/2018




## Tjetërsimi i pronave, nën hetim 30 zyrtarë të Hipotekës dhe ALUZINI-t

**DURRËS** - Pak ditë pas arrestimeve në Lezhë, edhe prokuroria e Durrësit ka nisur hetimet për tjetërsim pronash. Burime nga organi i akuzës së këtij rrethi bënë me dije se disa zyrtarë dhe ish-zyrtarë të Hipotekës dhe të ALUIZNI-t në Durrës, janë nën hetim për abuzime në bregdetin e Gjirit të Lalzit, Ishmit, Hamallajt dhe të Kallmit. Së paku mësohet se janë 30 funksionarë dhe zyrtarë aktualë që janë në hetim, të dyshuar për një skandal në tjetërsimin dhe falsifikimin e pronave në këtë vijë bregdetare. Sipas Tv Klan, hetimi nisi me arrestimin e ish-kryetarit të komunës Ishëm, Sulejman Ibrahimi dhe disa ish-vartësve të tij. Ai dyshohet se është përfshirë në abuzimin qindra hektarëve tokë ranore në Gjirin e Lalëzit. Por kërkimet e hetuesve zbardhën edhe zyrtarë të tjerë të përfshirë në këtë skandal dhe skema e abuzimit u zgjerua në sipërfaqe. Për këtë shkak, organi i akuzës në Durrës ka sekuestruar tashmë një numër të madh dosjesh pronësie të cilat po verifikohen. Mes personave që po hetohen, burimet për thanë se është edhe ish-drejtori i ALUIZNI-t në Durrës Flamur Gjuzi, si dhe paraardhësit e tij në këtë pozicion. E njëjta gjë vlen edhe për ish-kreun e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive në Durrës Ani Dyrmishi, zyrtarë, ish-zyrtarë dhe paraardhës të Dyrmishit. Zonat me të prekura abuzimet me pronat, janë ato bregdetare, ajo e Gjirit të Lalzit, në Ishëm, Hamallaj, Rrushkull, zona bregdetare e Katundit të Ri dhe ajo e Kallmit. Në këto zona dyshohet se zyrtarët kanë ushtruar veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve, me qëllim tjetërsimin e pronave, duke ua dhënë personave të ndryshëm në kundërshtim me ligjin. Fitimet nga abuzimi dhe shitja pronave llogariten marramendëse.

## SHKURT

### Tritol lokalit në Burrel, policia: U hodh nga dritarja e tualetit

**BURREL** - Policia ka dhënë detaje të reja në lidhje me shpërthimin që tronditi mbrëmjen e së dielës qytetin e Burrelit. Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur në lagjen 'Partizani', në një lokal bar kafe. Dyshohet se tritoli është hedhur nga dritarja e tualetit të lokalit. "Rreth orës 22.05 në sallën operative ka ardhur një telefonatë për një shpërthim në një lokal në lagjen "Partizani" në qytetin e Burrelit. Në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e policisë dhe grupi hetimor ku ka rezultuar se në lokalin 'Bar-Kafe', të marrë me qira nga shtetasi S.L, 35 vjeç, banues në Burrel, dyshohet se nga dritarja e tualetit të lokalit është hedhur një sasi lëndë plasëse, e cila ka shpërthyer. Nga shpërthimi nuk ka njerëz të lënduar, vetëm dëme materiale. Grupi hetimor po vijon punën për sekuestrimin e çdo prove të vlefshme që mund të ndihmojë në zbardhjen e ngjarjes. Ndërkohë, janë duke u marrë në pyetje 3 persona që mund të kenë dijeni për këtë ngjarje. Grupi hetimor vijon hetimet për zbardhjen dhe dokumentin e ngjarjes",- thuhej në njoftimin e policisë.

### Në makinë me pistoletë me vete, arrestohet kavajasi me dy emra

**DURRES** - Policia e Durrësit ka arrestuar një 35-vjeçar, pasi iu gjet me vete një armë zjarri me 17 fishekë. Në pranga ka përfunduar Nael Shala (Fatri Krasniqi), banues në Kavajë. Më datë 25.03.2018, në rrugën Golem-Durrës duke udhëtuar me një mjet tip 'Benz', pasagjer në mjet është arrestuar nga shërbimet e policisë pasi dispononte armë zjarri pistoletë tip 'Bereta' dhe 17 fishekë luftarakë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale" - thuhet në njoftimin e policisë. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit".

### Kërkohej në Itali për vrasje, përfundon në pranga 47-vjeçari

**VLORË** - Një 47-vjeçar i shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje është prangosur nga policia e Vlorës. Bëhet fjalë për shtetasin Fatmir Halla, banues në këtë qytet. Sipas bluve, ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma/Itali, pasi Gjykata e Asti/Itali e ka dënuar atë me 7 vjet burgim, për veprën penale "Vrasje me armë". Interpol Tirana në bashkëpunim me Interpol Roma/Itali, po kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme për ekstradimin e 47-vjeçarit drejt Italisë. Gjatë tre muajve të parë të këtij viti policia e Vlorës ka arrestuar disa persona të shpallur në kërkim për kryerjen e veprave të ndryshme penale.

Nënkomisar Bledar Kuçi dhe inspektor Idlir Ajazaj lejuan kalimin e mjetit lundrues

# Kapet gomonia me gjysmë ton kanabis në Itali, arrestohen 2 skafistët shqiptarë

## *Operacioni "Themis2018", prangosen dy policët kufitarë në Vlorë për shpërdorim detyre*

ITALI/ VLORË

Një gomone e mbushur me gjysmë ton kanabis, e nisur nga Shqipëria në Itali është sekuestruar në orët e para të mëngjesit të së dielës nga autoritetet italiane. Gjatë operacionit të koduar "Themis2018", u arrestuan edhe dy trafikantët shqiptarë që ndodheshin në bordin e gomones. Bëhet fjalë për 45-vjeçarin K.Skëndaj dhe 34-vjeçarin F.Soda. Mjeti lundrues rreth 7 m i gjatë dhe me një motor prej 200 kuaj fuqi u kap në brigjet e San Cataldo (Leçe). Për kapjen e tij u angazhuan një helikopter dhe një anije e Guardia di Finanza. Pas kapjes në Itali të gomones me 500 kg marijuanë kanë përfunduar në pranga edhe dy punonjës në Stacionin e Policisë Kufitare në "Tri Port" të Vlorës. Nënkomisar Bledar Kuçi, me detyrë përgjegjës turni dhe inspektor Idlir Ajazaj, me detyrë ndihmëskontrollor akuzohen për "Shpërdorim detyre". Sipas Policisë së Shtetit, në sajë të operacionit të përbashkët kundër trafikut të kanabisit, u bë e mundur sekuestrimi i lëndës narkotike.

**OPERACIONI**

Operacioni antidrogë është kryer nga agjencia "Frontex" me ndihmë nga ajri dhe deti. Sipas policisë italiane, nëse droga do arrinte të hidhej në treg, do t'i sillte organizatës fitime në vlerën 5 milionë euro nëse do të shitej me pakicë. Mësohet se dy skafistët shqiptarë u përpoqën të arratiseshin drejt brigjeve të San Cataldos, por ndërhyrja në kohë e forcave policore bëri të mundur edhe arrestimin e tyre si dhe sekuestrimin e gomones me lëndë narkotike. Kjo, pavarësisht faktit se ndjekja e skafistëve u zhvillua për disa orë në det në kushte të këqija atmosferike. Ndërkaq, Guardia di Finanza vijon hetimet për identifikimin e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të drogës nga Shqipëria në Itali dhe më tej në Europë. Në këtë operacion ka bashkëpunuar edhe policia shqiptare.

**ARRESTIMI I POLICËVE**

Policia e Shtetit përmes informacioneve konfideciale mësoi se gomonia dyshohej se mund të përdorej për trafik. "Në këtë moment, policia njoftoi palën italiane nëpërmjet Grupit të Kufirit Detar të Guardia di Finanza të vendosur në Durrës dhe Zyrës Ndërlidhëse të Policisë Shqiptare në Itali dhe ka nisur operacioni i ndjekjes nga ajri dhe deti, përfshirë misionin FRONTEX", thuhej ndër të tjera në njoftimin e Policisë së Shtetit. Blutë bënë me dije se nga hetimet e kryera ka rezultuar dhe është dokumentuar se dy punonjës të Policisë Kufitare në "Tri Port" nuk kanë kryer praktikën e rregullt ligjore për regjistrimin e mjetit lundrues tip gomone, i cili u kap në Brindizi me lëndë narkotike. Rezulton se mjeti lundrues, i cili figuron i regjistruar me dokumentacion në stacionin kufitar, ka hyrë në brendësi të pikës "Tri Port" dhe pa u regjistruar ka dalë më pas në det. Menjëherë, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA), Vlorë, arrestoi dy efektivët; nënkomisarin Bledar Kuçi dhe inspektorin Idlir Ajazaj. Ndërkaq, vijojnë hetimet në bashkëpunim me palën italiane.




Gomonia me drogë e sekuestruar në Itali

**OPERACIONI ANTIDROGË**

- **PERSONAT E ARRESTUAR NË ITALI**

1.K.Skëndaj 45 vjeç, skafist
2.F. Soda 34-vjeç, skafist

- **PERSONAT E ARRESTUAR NË SHQIPËRI**

1.Nënkomisar Bledar Kuçi, me detyrë përgjegjës turni në "Tri Port"
2.Inspektor Idlir Ajazaj, me detyrë ndihmës kontrollor në "Tri Port"

**5 MLN EURO**

Operacioni antidrogë është kryer nga agjencia "Frontex" me ndihmë nga ajri dhe deti. Sipas policisë italiane, nëse droga do arrinte të hidhej në treg, do t'i sillte organizatës fitime në vlerën 5 milionë euro nëse do të shitej me pakicë.

---

34-vjeçari drejtonte trafikun e heroinës

## Operacioni "Shqiponja e zezë" në Itali, Ekil Nderjaku, koka e grupit kriminal

**ITALI** - 34-vjeçari Ekil Nderjaku ishte koka e një grupi kriminal në Itali, që trafikonte drogë në vendin fqinj, por edhe në Zvicër. "Një lumë droge nga Shqipëria në Lombardi, e fshehur në pjesë të modifikuara të automjeteve", kështu shkruanin mediat italiane në lidhje me operacionin e koduar "Shqiponja e zezë". Pakot me heroinë ishin të destinuara për në tregun zviceran, në mënyrë të veçantë në Zyrih dhe transportoheshin duke kaluar kufijtë në Komasko. Ndërsa marijuana shpërndahej në veri të Italisë nëpërmjet një sistemi të mirëkoordinuar korrierësh. Paratë e fituara pastroheshin ose shkëmbeheshin me prerje më të vogla, duke bërë blerje në "Foks Taun" në Mendrisio. Ekil Nderjaku merrej me furnizimin e drogës në Shqipëri dhe me organizimin e transportit. Hetimet e nisura që në vitin 2013 sollën dhe sekuestrimin e 440 kg marijuanë; 10 kg heroinë dhe 220 kg sub-



stancë përzierëse. Për ndarjen dhe paketimin e drogës përdorej një apartament në Komo, ku jetonte një çift shqiptarësh, të dy nën hetim aktualisht. Gruaja, Adelina Tafa, sipas akuzës, kishte detyrën për të ndarë dhe paketuar heroinën. Bashkëshorti i saj, Shkëlzen Tafa, merrej me ruajtjen dhe depozitimin e drogës. Ndërkohë është zbuluar se korrierët që dërgonin marijuanën nga Komo në Rozano paguheshin 100 euro për një kg.

**Kush është Ekil Nderjaku?**

Emri i tij është i njohur si për autoritetet shqiptare dhe ato italiane. Në vitin 2011, ai është dënuar me burg në Shqipëri. Më herët akoma, në vitin 2005 ai është arrestuar nga policia italiane. Bëhet fjalë për një sasi rreh 19 kg heroinë të sekuestruar. Droga fshihej në banesën e muratorit shqiptar Pajtim Ahmeti. Ky i fundit në shtëpinë e tij kishte bërë një kasafortë në mur për të fshehur lëndën narkotike. Pjesë e grupit të shkatërruar në atë kohë ishin edhe marokenë. Heroina futej në tregun italian nga Kosova, ndërsa kokaina nga Holanda. Ekil Nderjaku, në momentin e arrestimit në vitin 2015 kishte fshehur 4.5 kg heroinë në altoparlantët e makinës së tij, tip "Lancia". Udhëheqësi i grupit nga ku e mori dhe "zanatin" Ekil Nderjaku ishte Rushit Selmanllari. Para se të arrestohej, ai ishte kthyer në Dibër, Shqipëri. Por pas rikthimit në Itali, një surprizë e pakëndshme e priste. Autoritetet e arrestuan atë sapo zbriti në aeroportin e Pizës.

---



### Sekuestrohen 98 kg drogë, arrestohen 2 persona nga Himara

**VLORË** - Dy persona janë vënë në pranga ditën e sotme nga policia e Vlorës, pasi u janë gjetur 98.3 kanabis. Bashkë me lëndën narkotike, dy shtetasve të arrestuar u janë sekuestruar edhe dy automjete tip "Benz". "Në kuadër të një procedimi penal proaktiv, të referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, specialistët e seksionit për Hetimin e Narkotikëve në D.V.P. Vlorë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Vlorë kanë zhvilluar dhe finalizuar operacionin duke sekuestruar 98.3 kg, lëndë narkotike dhe kanë arrestuar në flagrancë shtetasit: Nikolla Gërdhuqi, 31 vjeç, banues në Pilur, Himarë. Moisi Mëhillaj, 42 vjeç, banues në Kuç, Himarë. Në cilësinë e provës materiale është të sekuestruar sasia e lëndës narkotike dhe dy automjete tip "Benz". Materialet hetimore iu referuan për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Vlorës. Pritet që gjykata të vendosë masën e sigurisë ndaj tyre.

### Elmazi: Në Shqipëri 10.4 % e fëmijëve kategorizohen si PAK, kanë nevojë për shërbime

# Vetëm gjysma e personave me aftësi të kufizuar marrin pension invaliditeti

## *Marku: Padrejtësi me 1 mijë familje, iu hoq ndihma ekonomike*

Voltiza Duro

Rreth 141 mijë persona në vendin tonë rezul tojnë me aftësi të kufizuara e vetëm 67.741 prej tyre marrin pagesë invaliditeti e madje kjo kategori has një sërë vështirësish në përfitimin e shërbimeve publike. Gjatë tri dekadave të fundit ka rezultuar se këta qytetarë kanë plot pengesa në sigurimin e arsimimit të përshtatshëm, formimin profesional, punësimin, lirinë e lëvizjes, krijimin e një jetese të pavarur, ushtrimin e të drejtave politike, si dhe aksesin në informacion e shërbime. Ditën e djeshme, në qytetin e Lezhës u bë lançimi i projektit 3 vjeçar "Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të njerëzve me aftësi të kufizuara në Shqipëri". Në këtë aktivitet ishte e pranishme edhe zv.ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ardiana Jaku, e Alessandro Angius, përfaqësues i Bashkimit Europian në Tiranë. Ky projekt, i mbështetur nga BE, do të zbatohet në partneritet nga organizatat World Vision Albania, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, MEDPAK, si dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Brenda këtyre 3 viteve synohet të fuqizohen organizata të shoqërisë civile dhe 33 mijë individë në Berat, Korçë, Lezhë dhe Dibër. Nënkryetarja e Bashkisë Lezhë, Alfrida Marku, e pranishme në këtë aktivitet bëri me dije se pjesë e familjeve të përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike, janë plot 100 të tilla që në përbërje të tyre kanë një pjesëtar me aftësi të kufizuara. "Në Lezhë më shumë se 1 mijë familje janë përjashtuar padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike e 100 prej tyre kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuara, të cilat përveç kësaj kanë një realitet social dhe ekonomik mjaft të vështirë, çka në mënyrë absolute nuk duhej t'i përjashtonte ata. Faktet tregojnë që kemi shumë familje të kualifikuara si përfituese, të cilat demonstrojnë një realitet social dhe ekonomik shumë më të mirë sesa ato të përjashtuara padrejtësisht",-u shpreh Marku. Më tej kjo e fundit nënvizoi faktin se ndoshta nga ana e zyrës së punës ofrohet si alternativë punësimi në industrinë përpunuese, fasone, por harrohet nga ky institucion se përpara që t'i propozohet një qytetari një mundësi punësimi duhet detyrimisht të verifikohen kushtet fizike të punës dhe, nga ana tjetër, të hetohen saktë dhe qartë se sa respektohet paga minimale në këto vende pune. Nga ana tjetër, drejtoresha e World Vision në Ballkanin Perëndimor, Eljona Boce Elmazi bëri me dije se 10.4% e fëmijëve në Shqipëri kanë një aftësi të kufizuar. "Në Shqipëri 10.4 % e fëmijëve kanë një aftësi të kufizuar. Sipas të dhënave të Censusit, 6.2 % e popullsisë në vend janë me aftësi të kufizuar. Këta fëmijë kanë nevojë të marrin shërbimet e specializuara sot në mënyrë që të tejkalojnë barrierat e të kenë një jetesë të pavarur" - u shpreh Elmazi.


Lançimi i projektit 3 vjeçar "Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të njerëzve me aftësi të kufizuara në Shqipëri", dje në Lezhë



**1**
**MIJË**
"Në Lezhë më shumë se 1 mijë familje janë përjashtuar padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike e 100 prej tyre kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuara, të cilat përveç kësaj kanë një realitet social dhe ekonomik mjaft të vështirë, çka në mënyrë absolute nuk duhej t'i përjashtonte ata.

### Tirana Parking: 10 rrugët ku paguani 40 lekë në orë

# Parkimi me pagesë në kryeqytet, ja mënyra për të evituar tarifat e larta

Të gjithë ata persona që do të përdorin vendparkimet në kryeqytet, tashmë kanë mundësi t'i përfitojnë ato më lirë. Vendet e posaçme për parkim që hyjnë në zonën B, kanë një tarifim vetëm prej 40 lekësh të reja në orë, në ndryshim nga zona A, ku parkimi me pagesë është 100 lekë për një orë. Tirana Parking, i ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të tregohen sa më të kujdesshëm e të shmangin çfarëdolloj keqkuptimi apo ngatërrese në mënyrë që të tarifohen më pak. "Në rast se jeni duke parkuar në një nga 10 rrugët e Zonës B, ku pagesa e parkimit kryhet vetëm me një SMS në numrin 50500 (1 orë/40 lekë), ju lutemi të tregoni kujdes në dërgimin e mesazhit duke shkruar Targën e automjetit, HAPËSIRË, Zonën e tarifimit. Shembull (AA111AZ B) ose (TR2345Z B). Shkrimi i targës duhet të jetë pa hapësira",-thekson për banorët, Tirana Parking në postimin e publikuar në faqen e saj zyrtare. Sipas VKB Nr. 49 datë 11.11.2015, rrugët që do të kenë tarifimin për parkim vetëm 40 lekë për një orë, janë rrugët e zonës B. Respektivisht bëhet fjalë për bulevardin 'Zhan D'Ark' (Seg. 'Arkitekt Kasemi' - 'Odhise Grillo'); rrugën "Petro Nini Luarasi"; bulevardin 'Bajram Curri' (Seg. 'Kavajës' - 'Sulejman Delvina') si dhe rruga 'Janosh Huniadi'. Gjithashtu, edhe në rrugët 'Liman Kaba'; 'Perlat Rexhepi'; 'Dëshmorët e 4 Shkurtit' e 'Skënder Luarasi', tarifimi për parkin për një orë do të jetë 40 lekë. Kjo pagesë do të paguhet nga qytetarët edhe në momentin që parkojnë në bulevardin 'Bajram Curri' (Segmenti. 'Konti Leopold' - 'Teodor Muzaka') si dhe në rrugën e 'Kavajës' në segmentin '21 Dhjetori' - Pallati me shigjeta. Gjithashtu, për të shmangur çdo lloj keqkuptimi dhe ngatërrese me masën e tarifimit të parkimit publik, është e nevojshme që qytetarët që zotërojnë automjete duhet të jenë të saktë në momentin e dërgimit të mesazhit për pagesën e parkimit.




**RRUGËT E ZONËS B, TË MIRATUARA NË VKB NR. 49 DATË 11.11.2015, ME TARIFËN 1 ORË/40 LEKË JANË:**

- BLV. 'Zhan D'Ark' (Seg. 'Arkitekt Kasemi' - 'Odhise Grillo')
- 'Petro Nini Luarasi'
- BLV. 'Bajram Curri' (Seg. 'Rruga e Kavajës' - 'Sulejman Delvina')
- 'Janosh Huniadi'
- 'Liman Kaba'
- 'Perlat Rexhepi'
- 'Dëshmorët e 4 Shkurtit'
- 'Skënder Luarasi'
- BLV. 'Bajram Curri' (Seg. 'Konti Leopold' - 'Teodor Muzaka')
- 'Rr. e Kavajës' (Seg. '21 Dhjetori' - Pallati me shigjeta)





Gjatë simpoziumit



Themeluesi i universitetit elitar, "Aleks Luarasi": Debati shkencor sjell pasurim dijesh

# "Luarasi", simpozium për figurën e Skënderbeut

## Spiro Paço: Ja kumtesat që u prezantuan

Voltiza Duro

Në Kolegjin Universitar "Luarasi" ditën e djeshme është zhvilluar simpoziumi me tematikë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Arbëria në Epokën e tij". Gjatë këtij aktiviteti morën pjesë figura të njohura, kryesisht pedagogë të universitetit dhe themeluesi i këtij institucioni të lartë arsimor, Aleks Luarasi, i cili mbajti dhe fjalën e mirëseardhjes për të pranishmit. Duke rikujtuar këtë epope të lavdishme të Heroit Tonë Kombëtar në këtë vit jubilar, pedagogët dhe studentët e Luarasit referuan dhe morën në analizë marrëdheniet ekonomike dhe nderkombëtare të Skënderbeut. Profesor Aleks Luarasi, iniciator i këtij simpoziumi u shpreh se debati shkencor ka si qëllim të sjellë këndvështrime juridike dhe ekonomike në pasurimin e dijes për Skënderbeut dhe kohën e tij.


Gjatë simpoziumit të djeshëm me tematikë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Arbëria në Epokën e tij", në Kolegjin Universitar "Luarasi"

**KUMTESA**

"Disa persona kishin përgatitur edhe kumtesa, disa ese të shkurtra me tematika të ndryshme në kuadër të simpoziumit. Prof. as. dr Rezana Konomi, dekane e Fakultetit Juridik te 'Luarasi' mbajti në fjalën e saj, foli mbi traktatin e paqes ndërmjet lidhjes së princërve shqiptarë dhe Republikës së Venedikut",-tha Paço për 'GSH'.

### KUMTESAT

Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", Spiro Paço, pedagog i lëndës "Historia e Institucioneve dhe Historia e së Drejtës në Shqipëri" pranë fakultetit të Drejtësisë në këtë institucion elitar, tregon se në simpozium u paraqitën edhe disa kumtesa. "Disa persona kishin përgatitur edhe kumtesa, disa ese të shkurtra me tematika të ndryshme në kuadër të simpoziumit. Prof. as. dr Rezana Konomi, dekane e Fakultetit Juridik te Luarasi mbajti në fjalën e saj, foli mbi traktatin e paqes ndërmjet lidhjes së princërve shqiptarë dhe Republikës së Venedikut, më tej prof. as. dr. Mateo Spaho, dekan i Fakultetit Ekonomik, mbajti një fjalë të shkurtër mbi ekonominë mesjetare në Arbëri dhe veçoritë e saj në krahasim me Europën Perëndimore. Ndërkohë gjatë simpoziumit, drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, dr. Dorian Koçi në kumtesën e tij foli mbi figurën dhe imazhin e Skënderbeut në historiografinë gjermane në shekullin e XVI-të",-tregon Paço. Më tej, ky i fundit në fjalën e tij trajtoi temën mbi traktatin e Gaetës midis Alfonsit të Napolit dhe Gjergj Kastriot Skënderbeut, ndërsa një grup studentësh të Luarasit kishin përgatitur kumtesën mbi pasurinë e një familjeje fisnike në mesjetë, një krahasim mes Arbërisë dhe Europës Perëndimore. Gjatë simpoziumit është hedhur dritë edhe mbi dy traktate, sakaq studentët e juridikut dhe ekonomikut kanë referuar duke analizur kontratat e veçanta që kanë lidhur tregtarët shqiptarë me vendet fqinje. Synimi i këtij simpoziumi ishte të nxirrte në pah figurën qendrore të shekullit të XV, Simbol i bashkimit të princave shqiptarë në trojet arbënore. Shkrimtarë të shumtë nga të pesë kontinentet janë marrë me të drejtë me figurën e Gjergj Kastriotit, këtij burri të kombit shqiptar që me veprën e tij shkroi lavdinë e një kombi të tërë.

FOTO LAJM

## DHURATA E ISH-TË PËRNDJEKURIT POLITIK

Mosha dhe shëndeti nuk ia lejojnë të bëjë realitet shumë dëshira që ka, ndaj për këtë e ndihmon bashkëshortja e tij Nica. I nxitur nga aksioni i Bashkisë Tiranës për mbjelljen e pemëve, ish-i përndjekuri politik, Thanas Dhespo plotësoi dëshirën për të mbjellë dhe ai pemën e vet, si një mënyrë, jo vetëm për të kontribuar për gjelbërimin e qytetit, por edhe si simbol i përjetësimit.




STUDIMI

## Sasi të tepruara antibiotiku për shqiptarët

Sipas statistikave të indeksit të shëndetit për konsumatorët për 2017, Shqipëria renditet ndër vendet me përdorim të tepërt të antibiotikut. Të dhënat tregojnë se në një kohë që në Europë, rreth 36% e fëmijëve pacient marrin antibiotik, në Shqipëri kjo shifër është dy herë më e lartë, respektivisht përdoren 22.7 doza antibiotik për një mijë banorë. Në një kohë kur e gjithë bota po rrezikohet nga rezistenca ndaj antibiotikut edhe në vendin tonë specialistët e shëndetësisë apelojnë që mjekët të mos japin antibiotik pa kriter. Sipas Studimeve të ISHP në vendin tonë rreth 50% e antibiotikëve që shënohen në receta janë të tepruar. Referuar të dhënave zyrtare nga Doganat në vendin tonë për 2017 janë importuar rreth 986 milionë lekë antibiotik, prej të cilave 58 milionë leka janë preparate që përmbajnë penicilina dhe derivatet prej tyre ndërsa pjesa tjetër përmbajnë antibiotik.



DEBATI

# ARTISTËT TUBIM KUNDËR SHEMBJES SË TEATRIT

# Suela Konjari: Situata më kujton komunizmin që shembi kisha e xhami

Fatmira Nikolli

*"Të bëhet referendum popullor, s'kemi luks ta shembim"*

*Artistët: Kryeministri Rama të ndiqet penalisht, shemben dy teatro*

Artistët janë mbledhur dje para Teatrit Kombëtar për të kundërshtuar shembjen e tij. "Rama të ndiqet penalisht" tha Rudi Sata, kryetar i Sindikatës së Artistëve dhe Punonjësve të TKOBAP. Ai ka bërë thirrje që kryeministri Edi Rama të ndiqet penalisht, ndërsa ka deklaruar se nuk do të lejohet që të shembet Teatri Kombëtar. Dëgjesa e artistëve u bë në oborrin para Ministrisë së Brendshme mes dy godinave të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental.

Gjatë dëgjesës me artistë dhe qytetarë pasditen e djeshme ishin të pranishëm edhe arkitektë. Kreshnik Merxhani dhe Arben Biçoku janë solidarizuar me artistët duke kërkuar më shumë transparencë. Merxhani u shpreh se "Ideja se restaurimi i godinave është më i shtrenjtë, se ndërtimi nga e para është një mit. Nuk mund të shfuqizohet godina e TK pa transparencë"-tha ai. Shkrimtari Behar Gjoka tha se "Një qytet pa teatër është si një njeri pa gojë. Si ka mundësi që ministrja Kumbaro nuk di që ka projekt, kur ai është prej vitesh në kokën e Ramës". Ndërsa regjisori Bujar Kapexhiu ftoi Ramën që të tërhiqet nga vendimi për të shembur teatrin. "Miku im, tërhiqu thuaj s' do të shembet. Tërheqja është zemërgjerësi, të presim". Aktori Arben Derhemi është shprehur se artistët nuk do të lejojnë që të shembet teatri. "Teatri Kombëtar nuk do të shembet"-tha ai. Një pjesë e aktorëve e kundërshtojnë vendimin për shembjen e Teatrit Kombëtar dhe projektin e ri që u prezantua pak ditë më parë nga kryeministri Rama.


Suela Konjari


Ahmet Pasha

## SUELA KONJARI

Aktorja Suela Konjari tha për "GSH" se është një histori 20- vjeçare kjo që sot po rijetojmë. "Projekti i Teatrit, siç e dimë të gjithë u prezantua nga zoti kryeministër në kryeministri përpara një grupi artistësh të përzgjedhur. Gjithë ne të tjerët u njohëm nga media",- tha Konjari. Ajo theksoi se teatri është aset kombëtar, i shërben e i përket të gjithëve.

"Mendoj që është detyrë e qeverisë të marrë (jo të njoftojë apo të vërë në dijeni) mendimin jo vetëm të artistëve, por duke e konsideruar vlerën reale të këtij problemi, të marrë mendimin e komunitetit, të bëjë një referendum popullor", - tha aktorja e njohur.

Në prononcimin e saj për "GSH" Suela Konjari tha se teatri është pasuri kulturore e historike. "Të prishësh Teatrin, t'i vësh kazmën godinës, mendja të shkon në vite të errëta kur prishën kisha e xhami.... Mendoj që ne shqiptarët tani më shumë se kurrë, nuk e kemi luksin të prishim ..."

Konjari tha se do jetë mrekulli të ndërtojmë një Teatër të ri, por pa prishur këtë ekzistues, pa zhbërë e fshirë memorien e historisë!

"Ky teatër është tempull i historisë së artit shqiptar! Në këtë Teatër është fryma e korifenjve të skenës sonë. Unë personalisht do ndjehesha zemergëzuar që Teatri i ri të ketë vulën e arkitekteve shqiptarë. Pra unë jam që ky Teatër të mos shembet, por të rikonstruktohet!

Të ndërtohet dhe një teatër i ri, do ishte mrekulli!", sqaroi Konjari për "GSH".

Sipas saj, teatri ekzistues është memorie historike e kulturore! Si e tillë do ruajtur me kujdes e shumë dashuri!

## AHMET PASHA

"Që kur kam ardhur në fillim në teatër, në vitin 1970, që jam emëruar, siç ishte në atë kohë, ka qenë ideja për të bërë një godinë të re, sepse që në atë kohë, kjo si godinë trajtohej si e amortizuar",- tha Pasha. Kur filloi për herë të parë debati për shembjen e kësaj godine ekzistuese, Pasha ka qenë në mbrojtje të kauzës së teatrit, së bashku me emra të mëdhenj të skenës. "Ka filluar që në vitin 1999. Që atëherë ka qenë ideja për t'u prishur kjo godinë. Natyrisht në atë kohë kanë qenë njerëz të tjerë në krye të asaj pune.


Aktorët gjatë protestës se djeshme

Kanë qenë emra të mëdhenj të teatrit si Vangjush Furxhiu, Agim Qirjaqi, Roland Trebicka. Unë kam qenë kryetar sindikate, natyrisht isha edhe unë në krye të kësaj pune",-u shpreh ai. Ndërsa sot artistët nuk janë në një zë, por edhe një qëllim i përbashkët. "Për këtë rast duhet të ishim të gjithë një mendje. Për një godinë të mirë, të re, të teatrit të ri. Teatri ka gjithë jetën që po e vuan. S'ka një godinë, qoftë për veten e vet, qoftë edhe për spektatorin që mbaj mend këto 15-20 vite nuk e ka hequr pallton e dimrit",- u shpreh Ahmet Pasha. Një projekt i ri për një godinë të re tashmë ekziston, por për Ahmet Pashën pavarësisht se godina është tërheqëse, sërish duhen dëgjuar edhe arkitektët vendas. "Nga këto që shoh unë, projekti i Bujarit, krahu i Teatrit Eksperimental, të gjitha këto, mbase edhe ideja e shumë arkitektëve të tjerë, që deri më sot nuk janë prononcuar, do të sjellë diçka më interesante",-tha aktori

BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.
INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

## Deklarata e serbit: Kosova s'do jetë kurrë e pavarur

# Policia e Kosovës arreston shefin e zyrës, Marko Gjuriç, tensionohet situata me Serbinë


Policia e Kosovës gjatë arrestimit të shefit të zyrës, Marko Gjuriç

Shefi i Zyrës për Kosovën në qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç ka bërë një fjalim me tone forta dje para serbëve të Kosovës në Mitrovicë, duke theksuar se për Serbinë, Kosova s'do jetë kurrë e pavarur dhe as pjesë e Shqipërisë së madhe. Para arrestimit nga policia e Kosovës, pasi shkeli ndalesën e lëshuar nga qeveria kosovare, Gjuriç tha se pa serbët e Kosovës nuk ka zgjidhje për këtë vend. Me ardhjen e zyrtarëve nga Beogradi, në Mitrovicën Veriore ka nisur, siç është thënë, tryeza e rrumbullakët për dialogun e brendshëm për Kosovën, me temën "Forcimi dhe mbijetesa e institucioneve serbe në Kosovë". "Ne kemi ardhur sot këtu në Mitrovicë ashtu siç edhe kemi premtuar, ashtu siç jemi marrë vesh para disa ditësh, kur me nismën e Vuçiç kemi bërë thirrje për këtë tryezë të rrumbullakët, në mënyrë që me serbët e Kosovës të bisedojmë për të ardhmen e vendit tonë", ka thënë Gjuriç në hapje të takimit. "Pa ju, pa serbët e Kosovës, nuk ka zgjidhje për Kosovën. Për Serbinë, veriu i Kosovës nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë pjesë e të ashtuquajturës Kosovë e pavarur e as pjesë e të ashtuquajturës Shqipëri e madhe", ka thënë Gjuriç. Ndërkaq, Nikola Selakoviç u ka bërë thirrje të tubuarve që të shfaqin mendimet e tyre për atë se si e shohin luftën e mëtejshme të autoriteteve serbe për Kosovën. Kurse kryetari i komunës së Mitrovicës Veriore, Goran Rakiç ka ftuar presidentin e Serbisë që të fillohet me formimin e njëanshëm të asociacionit të komunave me shumicë serbe, duke theksuar se shqiptarët (institucionet e Kosovës) nuk janë në gjendje që ta kryejnë këtë punë. Paraprakisht nga Ministria e Jashtme të Kosovës ishte konfirmuar për radion "Evropa e Lirë" se kjo ministri u kishte refuzuar kërkesën për vizitë të drejtorit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç dhe sekretarit të përgjithshëm të presidentit të Serbisë, Nikolla Sellakoviç. Ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka deklaruar se ndalesa që i është vënë vizitës së Gjuriçit dhe zyrtarëve tjerë serbë ndërlidhet me deklaratat e tyre nxitëse dhe mos përfilljen e marrëveshjes për vizitat reciproke.

> **MARKO GJURIÇ**
> "Pa ju, pa serbët e Kosovës, nuk ka zgjidhje për Kosovën. Për Serbinë, veriu i Kosovës nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë pjesë e të ashtuquajturës Kosovë e pavarur e as pjesë e të ashtuquajturës Shqipëri e madhe", ka thënë Gjuriç.

## Flakët përpijnë ndërtesën në Kemerovo, njerëzit hidhen nga dritaret për të shpëtuar jetën

# Tragjedia në Rusi, 64 viktima në qendrën tregtare

## *Zjarri në qytetin siberian, humbin jetën 41 fëmijë*



Qendëra tregtare të qytetit siberian Kemerovo, ku ra zjarri

Një zjarr gjigant përfshiu një qendër të madhe tregtare të qytetit siberian Kemerovo, duke marrë të paktën 64 jetë njerëzish. 48 u plagosën dhe 16 të tjerë rezultojnë të zhdukur e sipas zyrtarëve ruse, 41 prej viktimave të flakëve që gllabëruan katet e sipërme të qendrës që kishte edhe një kompleks argëtimi, mund të jenë fëmijë. Zjarri nisi pikërisht në katin e fundit të godinës 4-katëshe, ku ndodhej kompleksi "Winter Çerri". Deri më tani sipas BBC, 41 fëmijë mund të jenë në mesin e viktimave, thonë zyrtarët rusë. Flakët nisën në katin e katërt të qendrës tregtare, ndërsa shumë nga viktimat ishin në kinema. Në ato momente, shumë prej viktimave gjendeshin në kinema. Për t'i shpëtuar ferrit të flakëve, disa njerëz kanë tentuar deri edhe të hidhen nga dritaret. Sfungjeri te këndi i lojërave, thonë dëshmitarët, ka marrë flakë si të ishte barut. Gati 660 punonjës të emergjencës u dërguan në vendngjarje, ku përmes ndërhyrjes së tyre, 22 persona u arrit të shpëtoheshin nga një situatë e vështirë, ndërsa 100 të tjerë u evakuuan pa probleme. Zjarri u vu nën kontroll dhe autoritetet nisën një hetim mbi çështjen. Flakët kanë rënë mbrëmjen e të dielës dhe përfshinë fillimisht një kënd lojërash për fëmijë në katin e katërt të qendrës tregtare në qytetin siberian të Kemerovos. Dëshmitarët thanë se flakët u shkaktuan nga një fëmijë që luante me çakmak. Të tjerë hodhën dyshime se shkak ishte një shkëndijë elektrike. Flakët u përhapën me shpejtësi në të gjithë ndërtesën. Një pjesë e kateve të sipërme u shkatërruan krejtësisht, ndërsa njerëzit vraponin për të dalë jashtë ndërtesës. Mediat ruse shkruajnë se një klasë e tërë nxënësish të një shkolle fillore është shuar. 8 fëmijë të një shkolle të qytetit të shoqëruar nga mësuesi i tyre kishin shkuar për të vizituar një shfaqje me kartonë në këtë qendër. Bilanci tragjik nga rënia e një zjarri në ambientet e një qendre tregtare në qytetin Kemerovo të Rusisë çoi në 56 numri e personave të vdekur dhe 48 të tjerë të plagosur, ndërsa shumë janë ende të zhdukur. Mediat ruse raportojnë se mes viktimave janë me dhjetëra fëmijë, të cilët kanë qenë në kinemanë e qendrës tregtare, ditën e diel. Deri më tani raportohen 11 fëmijë të vdekur, ndërsa vijojnë kërkimet për nxjerrjen e trupave të tjerë nga rrënojat që ka shkaktuar zjarri. Autoritetet raportojnë se mundësitë për të nxjerrë trupa të gjallë janë pothuajse zero dhe për pasojë bilanci tragjik pritet të rritet, pasi zjarri ishte i fuqishëm dhe ka shkrumbuar qendrën tregtare. Qendra Tregtare u përfshi nga flakët në një kohë kur brenda saj kishte fluks frekuentuesish. Nuk dihet çfarë e ka shkaktuar ngjarjen tragjike, por mediat ruse kanë publikuar video nga momenti kur ka shpërthyer zjarri në qendrën tregtare.

> **SHUHET NJË KLASË FILLORE:**
> Mediat ruse shkruajnë se një klasë e tërë nxënësish të një shkolle fillore është shuar. 8 fëmijë të një shkolle të qytetit të shoqëruar nga mësuesi i tyre kishin shkuar për të vizituar një shfaqje me kartona në këtë qendër.



> **DËSHMITARËT:**
> Dëshmitarët thanë se flakët u shkaktuan nga një fëmijë që luante me çakmak. Të tjerë hodhën dyshime se shkak ishte një shkëndijë elektrike. Flakët u përhapën me shpejtësi në të gjithë ndërtesën.



> **BILANCI**
> 56 është numri e personave të vdekur dhe 48 të tjerë të plagosur. Deri më tani raportohen se 11 fëmijë kanë humbur jetën, ndërsa vijojnë kërkimet për nxjerrjen e trupave të tjerë nga rrënojat që ka shkaktuar zjarri. Gati 660 punonjës të emergjencës u dërguan në vendngjarje, falë ndërhyrjes së të cilëve, 22 persona u arrit të shpëtoheshin nga një situatë e vështirë, ndërsa 100 të tjerë u evakuuan pa probleme.

## ISH-PRESIDENTI



### Plas dhuna në Barcelonë pas arrestimit të Carles Puigdemont

Pas lajmit të ndalimit të ish-presidentit Puigdemont ditën e djeshme, ka nisur dhuna e tensionet në Barcelonë. Rreth 55 mijë mbështetës të kauzës së pavarësisë të mbledhur në qendër të Barcelonës u përleshën me forcat speciale të ardhura nga Madridi. Të lënduar mbetën më shumë se 80 persona, ndërsa policia arrestoi disa protestues. Manifestuesit bllokuan edhe rrugët e autostradat hyrëse të qytetit. Të dielën, policia gjermane njoftoi ndalimin e Carles Puigdemont në rrugën e kthimit nga Finlanda në Belgjikë ku jeton në arrati. Së bashku me 25 politikanë separatistë rrezikon deri 30 vite burg, me akuzën e shpalljes së pavarësisë së Katalonjës përmes referendumit antikushtetues të 1 tetorit të vitit të kaluar. (11)

Agjencia e Trajtimit të Pronave: Përfituesit kanë edhe 4 muaj kohë për të plotësuar dokumentet

# Vendimet e vitit 1997, emrat e 1462 pronarëve që kompensohen

## *Kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitet 1993-1997 rreth 17 318 vendime*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara në të gjithë vendin. Në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje. Numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP-ja është 17 318 vendime. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e vitit 1997 së bashku me vlerën financiare.

**MUNGESA E DOKUMENTACIONIT**

Sipas ATP-së, në rastet kur subjektet e interesuara nuk sjellin dokumentacion të nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimit të kompensimit brenda afatit 6-mujor nga data e publikimit të regjistrit, si dhe në rastet kur ATP-ja është në pamundësi objektive për të vlerësuar pronën, bazuar në dokumentacionin që disponon vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht. Pronarët kanë edhe 4 muaj kohë për plotësimin e dokumenteve dhe ATP njofton të gjitha subjektet, që për çdo informacion apo paqartësi lidhur me të dhënat e publikuara në regjistër apo që nuk i gjejnë të publikuara në të, mund të paraqiten pranë sporteleve tona për sqarime dhe informacion më të detajuar. Gjithashtu, ATP ka filluar punën dhe së shpejti do të përfundojë procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të vitit 1998 dhe në vijim sipas rendit kronologjik do të vlerësohen të gjitha vendimet, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

**DOSJET E PËRFUNDUARA**

Me përfundimin e procesit të vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të vitit 1997, si dhe nga përditësimi i regjistrit të vendimeve për vitet 1993-1996, numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP është 17 318 vendime. ATP, nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.133/2015 e deri më tani ka përfunduar vlerësimin financiar për 67% të të gjithë vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me ecurinë e punës së deritanishme, kjo falë edhe sistemit "Web-Gis" të implementuar nga ATP, ky proces parashikohet të përmbyllet përpara afatit të përcaktuar në ligj për përfundimin e vlerësimit financiar të të gjitha vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

**EMRAT E 1462 PRONARËVE QË KOMPENSOHEN**

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues*) | Atesia | Mbiemri (*Subjekti Kerkues*) | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Fier | Edmond Pogaçe | | | |
| Gjirokastër | Qani Çibuku | | | 339,904 |
| Gjirokastër | Qani Nuraj | | | 372,478 |
| Gjirokastër | Xhafer Sulo Meçe | | | 6,510,255 |
| Lezhë | Tonin Merdhoqi | | | |
| Lezhë | Mark Bibe Doda | | | 635,983 |
| Korçë | | | | 154,190 |
| Tiranë | GANI MURATI | | | |
| Korçë | Haki Kurili | | | 585,923 |
| Korçë | Nesti Kotmilo | | | 747,823 |
| Korçë | Jorgjia Thimo | | | 703,108 |
| Korçë | Vasilika Çekani | | | 4,023,338 |
| Korçë | Isa Bliri | | | 770,855 |
| Korçë | Ali Hasankolli | | | 863,465 |
| Korçë | Hysen Qerimi | | | 878,884 |
| Korçë | Ervehe Laze | | | 646,057 |
| Korçë | Nazliko Tefiku | | | 1,460,901 |
| Korçë | Pashako Shuli | | | 426,922 |
| Korçë | Mirash Zeqo | | | 324,581 |
| Korçë | Ali Petritaj | | | 411,603 |
| Korçë | RAKIBE PANE | | | 0 |
| Korçë | Leonidha Mujo | | | 3,622,728 |
| Shkodër | Kol Shiroka | | | 533,498 |
| Shkodër | Tonin Kromiçi | | | 185,028 |
| Shkodër | Zef Loro Kiri | | | |

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues*) | Atesia | Mbiemri (*Subjekti Kerkues*) | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Shkodër | Hasan Radovic | | | 959,406 |
| Shkodër | Veneranda Paliku | | | 616,761 |
| Shkodër | Ballkiz Shehi | | | 231,285 |
| Korçë | Gurtali Fezolli | | | 258,194 |
| Korçë | Ibrahim Brame | | | 514,899 |
| Korçë | Vangjo Nune | | | 1,083,443 |
| Korçë | Mustafa Seit Mekellari | | | |
| Korçë | Sotiraq Terova | | | 7,508,037 |
| Korçë | Llazar Burnazi | | | |
| Korçë | Violeta Bajraktari | | | 2,432,814 |
| Korçë | Shefki Pillati | | | |
| Korçë | Emin Bregu | | | 604,426 |
| Korçë | Hysen Shahinllari | | | 971,399 |
| Shkodër | Trashgimtarët e Jakup Salı | | | 831,485 |
| Shkodër | Trashgimtarët Elez Can La | | | 117,185 |
| Elbasan | NIGJARE BARDHOSHI | | | 109,646 |
| Berat | Nazmi Shahu | | | 25,904 |
| Berat | Nazmi Shahu | | | 1,222,329 |
| Berat | Bahije Tusha | | | |
| Berat | Gëzim Braho | | | 1,134,109 |
| Berat | | | | 863,465 |
| Berat | Shkëlqim Musabelliu | | | 314,411 |
| Berat | Shkëlqim Musabelliu | | | 584,781 |
| Korçë | | | | 71,955 |
| Korçë | Nihat Sulkollari | | | 9,922,182 |

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues*) | Atesia | Mbiemri (*Subjekti Kerkues*) | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Korçë | ALBERT ÇORBAXHIU | | | 179,276 |
| Korçë | | | | 6,807,671 |
| Korçë | Pandi Berberi | | | 17,989 |
| Korçë | Gazmend Çorbaxhi | | | -699,553 |
| Korçë | | | | -2,749,119 |
| Kukës | Azem Hoxha | | | |
| Kukës | Ramazan Muça | | | |
| Korçë | Hasan Bajko | | | 1,325,899 |
| Kukës | Sahit Xhebexhia | | | |
| Lezhë | Llesh Preng Kacorri | | | |
| Lezhë | Zef Ded Brunga | | | |
| Lezhë | Preng Ded Deda | | | |
| Korçë | LIRIKA KANE | | | 233,280 |
| Korçë | | | | 59,110 |
| Dibër | XHELAL STANA | | | |
| Korçë | Mysteak Xhixho | | | -88,100 |
| Korçë | Kasëm Jaupi | | | -78,200 |
| Dibër | ISMAIL MUHARREMI | | | 1,370,352 |
| Korçë | Livi Shanazo | | | |
| Dibër | BAJRAM ÇEKU | | | 2,151,993 |
| Dibër | SALI DEDOLLI | | | 926,275 |
| Korçë | Njazi Potomi | | | 37,000 |
| Dibër | HAMIT LETI | | | 83,000 |
| Dibër | SELIM HASA | | | 1,569,657 |
| Dibër | AHMET BOZA | | | 752,448 |
| Dibër | Hajrulla Dishani | | | 236,311 |

| | | |
|---|---|---|
| Dibër | Hamit Metuku | 855,863 |
| Elbasan | TODI SULONJAKU | |
| Elbasan | MEHMET BARDHI | |
| Fier | Vath Buzi | 2,999,743 |
| Fier | Ylbere Doda | 11,087,620 |
| Fier | Razie Kumani | 25,622,590 |
| Fier | Dashamir Balla | 7,886,774 |
| Fier | Zylfie Gashi | 855,470 |
| Fier | Xhemal Beqiri | |
| Fier | Donika Çoçoli | |
| Fier | Xhumuriet Vlushaj | 3,595,031 |
| Fier | Gjylo Lako | 1,421,291 |
| Fier | Kadri Kodheli | 5,796,640 |
| Fier | Ylbere Doda | 232,508 |
| Korçë | Emine Tarelli | 1,705,582 |
| Korçë | Kiço Filo | 44,258 |
| Lezhë | Prena Mark Kola | |
| Lezhë | Gjon Koli Perkeqi | 383,762 |
| Lezhë | Preng Ndue Dushku (Niko | 603,466 |
| Lezhë | Preng Nikolle Ndoji | 41,254 |
| Vlorë | Mynyr Cobo | 50,400 |
| Lezhë | Frrok Kole Perkeçi | 383,762 |
| Elbasan | DHIMITER TOCI | 8,149,327 |
| Fier | Hysen Nazeraj | 858,833 |
| Fier | Kujtime Xhafaj | |
| Fier | Hekuran Bideri | |
| Fier | Barjam Barjami | |
| Fier | Kaso Zotaj | |
| Fier | Nateme Veliaj | -550,000 |
| Fier | Jonuz Brahimaj | |
| Fier | Muharrem Avdiaj | |
| Korçë | Ollga Tabaku | 1,807,110 |
| Korçë | Qerim Nake | 121,088 |
| Vlorë | Mukadez Sulejmani | 94,160 |
| Vlorë | Neshat Osmani | 363,440 |
| Berat | Iljaz Metani | 1,292,114 |
| Berat | Isuf Nuellari | 0 |
| Fier | Beqo Hoxha | 1,768,868 |
| Berat | Hajder Hysi | 2,723,000 |
| Gjirokastër | Jonuz Naci | |
| Korçë | Demir Keco | 169,136 |
| Korçë | Hekuran Xhango | 191,881 |
| Korçë | Islam Asllan Myrte | 1,527,696 |
| Korçë | | 2,274,738 |
| Korçë | | |
| Korçë | BEQIR BYLYKBASHI | 533,813 |
| Tiranë | MUSA AHMET SUDI | 1,168,720 |
| Tiranë | HAMDI REKA | |
| Vlorë | Baftjar Caushi | 325,741 |

| | | |
|---|---|---|
| Vlorë | Engjell Runa | 3,678,278 |
| Vlorë | Kojdhel Isaraj | 4,986,170 |
| Vlorë | Bilbil Labaj | 271,238 |
| Vlorë | Bektash Tahiraj | 628,137 |
| Vlorë | Fadil Capo | |
| Vlorë | Serri Kurti | 13,260,000 |
| Vlorë | Demir Islamaj | 1,161,338 |
| Vlorë | Mitat Bellaj | 2,838,197 |
| Vlorë | Iljaz Iljazi | 566,506 |
| Korçë | Ferit Ago | 680,219 |
| Korçë | Pandi Zhato | 1,574,065 |
| Korçë | Pleurat Caco | 2,078,073 |
| Tiranë | HAJDARI | |
| Tiranë | HASAN RAMAZAN BOGDANI | |
| Tiranë | XHAVIT DIBRA | |
| Tiranë | | 1,918,812 |
| Tiranë | ZYDI SHIJAKU | |
| Tiranë | THACI | |
| Korçë | Lytfi Berberi | |
| Elbasan | ADHURIM KAOLI | |
| Elbasan | MEHMET BALLKOCI | 256,881 |
| Gjirokastër | Hajri Bilo Llakaj | 773,007 |
| Korçë | Feim Pasho | 1,096,875 |
| Durrës | Nazmi Shehi | |
| Lezhë | Mark Frrok Gjeci | 686,944 |
| Lezhë | Preng Mark Prenga | 282,129 |
| Lezhë | Dede Ndue Gjeci | |
| Lezhë | Pashk Nikoll Prendi | |
| Durrës | Ramazan Çopa | |
| Durrës | Vjollca Dedja | 4,407,000 |
| Korçë | Mitat Mero | |
| Durrës | Vita Mazniku | -530,400 |
| Gjirokastër | Shaje Allkaj | |
| Durrës | Abdulla Shehi | |
| Korçë | Nevruz Subashi | 2,054,088 |
| Fier | Llazar Koço | 2,072,317 |
| Fier | Sokrat Naçi | 3,121,119 |
| Fier | Ndoni Silo | 6,089,030 |
| Fier | Nimete Mala | |
| Fier | Refat Selfo | 2,021,021 |
| Fier | Hidajet Mala | 1,170,475 |
| Fier | Hysen Malaj | |
| Fier | Miti Janku | 8,591,494 |
| Korçë | Mitika Uci | |
| Korçë | | 477,960 |
| Lezhë | Gjyste Leshi | 387,251 |
| Fier | Nikollaq LIço | |
| Durrës | Hamid Balla | 2,738,574 |
| Gjirokastër | Neim Barjam Kanani | 1,505,811 |

| | | |
|---|---|---|
| Fier | Tahir Kallëmbi | |
| Gjirokastër | Bashkim Shytaj | |
| Durrës | Rifat Shkodra | 6,840,147 |
| Durrës | Ismail Meça | 10,504,858 |
| Durrës | Hatixhe Dani | 649,782 |
| Korçë | LUAN KOLAMI | -232,552 |
| Korçë | Teki Gegolli | |
| Korçë | Eqerem Avxhi | 103,530 |
| Dibër | BARDHYL KADIU | 3,088,739 |
| Lezhë | Frok Llesh Reci | -2,768,525 |
| Lezhë | Gjon Mark Reci | 2,845,484 |
| Tiranë | Besnik Bashmeta, Halil Bashmeta | |
| Tiranë | RAMIZ CELA | 329,000 |
| Tiranë | XHEMILE MALIQATI | 3,948,000 |
| Tiranë | HAMIDE KOKA | |
| Tiranë | Kadife Dedej(Dervishi) | 723,552 |
| Tiranë | MEREME XHAHYSA (K | 414,829 |
| Tiranë | Drita Gashi, Feride Gash | 1,570,913 |
| Tiranë | ANISHA HENCI | 3,190,836 |
| Tiranë | Mereme Hoti ( Boletini ), | 1,197,704 |
| Tiranë | Sadete Hadja, Shyqyri H | 2,585,000 |
| Tiranë | FATIME, OLIMBI, KUM | 7,502,418 |
| Tiranë | HATIXHE CELPICA | 3,026,800 |
| Tiranë | Ali Thertori | 659,569 |
| Tiranë | Haxhi Hallulli, Shefqet Hal | 1,826,812 |
| Tiranë | Arta Fagu | 3,424,805 |
| Tiranë | Ramiz Çela | 458,066 |
| Tiranë | Ramiz Cara | 5,317,211 |
| Dibër | Qemal Allamani | 2,055,808 |
| Korçë | Hasan Emin Skerma | 2,551,030 |
| Vlorë | Astrit Kallapodhi | |
| Korçë | Zikuli Karanxha | 55,987 |
| Dibër | Ramazan Ceku | |
| Korçë | Yzret Meço | 232,068 |
| Korçë | Viktor Konomi | -12,669 |
| Vlorë | Myzejen Zejnati | |
| Fier | Shefqet Buzi | 7,682,923 |
| Fier | Thoma Haxhistasa | |
| Fier | Thanas Duda | 9,173,566 |
| Fier | Bilbil Kerri | |
| Fier | Hysen Çoçoli | |
| Fier | Përparim Alizoti | 3,121,268 |
| Gjirokastër | Spartak Xhuvani | -413,340 |
| Gjirokastër | Shezai Shehu | 323,182 |
| Gjirokastër | Kristaq Çipi | |
| Gjirokastër | Foni Dilo | 73,800 |
| Korçë | Gurtali Fezolli | |
| Korçë | Kostandina Ktona | |
| Korçë | Xhevdet Dervishi | 675,710 |

| | | |
|---|---|---|
| Korçë | Kujtim Demko | 99,500 |
| Korçë | Shpëtim Çaushllari | 254,400 |
| Korçë | Ropi Shurdhi | -18,458 |
| Korçë | Ibrahim Qose | 240,000 |
| Korçë | Novruz Pino | 190,000 |
| Korçë | Bajram Pane | |
| Korçë | Vangjel Pelteku | 773,500 |
| Korçë | Shpetim Iliri | 400,000 |
| Elbasan | MUHAMET GJONI | 165,749 |
| Elbasan | XHEMAL STOJKU | 1,633,731 |
| Korçë | Kadrije Agolli | 219,272 |
| Korçë | | 1,010,000 |
| Elbasan | DEMIR REXHEPI | |
| Vlorë | Koco Kristo | |
| Vlorë | skender Godo | |
| Korçë | Vasfi Staro | |
| Korçë | Gurali Dervishllari | |
| Korçë | Vasfi Nevrus | 3,924,912 |
| Vlorë | Vasil Dharmi | 54,912 |
| Korçë | Ylli Sulo | 1,398,086 |
| Korçë | Xhelal Vasha | 1,289,030 |
| Durrës | Sanije Hoti | -2,275,000 |
| Durrës | Bahtije Feri | 2,925,000 |
| Durrës | Hysen Dizdari | 936,000 |
| Durrës | Jovan Prifti | |
| Durrës | Ramazan Dika | 862,000 |
| Durrës | Fadil Feri | |
| Gjirokastër | Poli Xhello | 55,770 |
| Korçë | Gjergji Shkurti | |
| Korçë | Eleni Fushi | 643,500 |
| Korçë | AHMET ÇETA | |
| Korçë | Nuri Pleku | 261,180 |
| Tiranë | HYKA | 1,719,366 |
| Gjirokastër | Novruz Varfi | |
| Korçë | Selami Elezi | 1,010,207 |
| Korçë | Sotir Robo | 523,119 |
| Korçë | Avdulla Myteveli | 1,958,607 |
| Korçë | Neki Kroi | 1,356,211 |
| Korçë | Guri Tili | 278,500 |
| Korçë | Qani Lazelliu | 147,926 |
| Korçë | Sefer Kacka | 413,108 |
| Korçë | Bedri Spahillari | 2,124,536 |
| Korçë | Ramadan Hysollari | |
| Korçë | Teki Kodrasi | 497,558 |
| Berat | NURI ÇONGO | 877,968 |
| Berat | NURI ÇONGO | 380,367 |
| Berat | Qemal Alushani | 35,138 |
| Berat | Qemal Alushani | 585,630 |
| Berat | Fatime Llango | 1,423,829 |

| | | |
|---|---|---|
| Berat | Bido Duçellari | 1,683,665 |
| Berat | Xhevdet Molla | 3,478,642 |
| Korçë | Demirali Collaku | 2,140,803 |
| Gjirokastër | Qani Veiz Jeniçeraj | 3,150,256 |
| Korçë | Kristo Plaku | 11,304,583 |
| Durrës | Ibrahim Halili | 1,063,654 |
| Durrës | Shaban Kurti | 3,738,252 |
| Durrës | Mehmet Hoxha | |
| Elbasan | XHAZAI SULOLLARI | 583,129 |
| Elbasan | RAKIPE ZENEL GURRA | 129,571 |
| Gjirokastër | Vangjel Angjeli | 72,421 |
| Dibër | SHAQIR KOKA | |
| Korçë | Radium Avxhi | 306,000 |
| Dibër | LIHE PALI | |
| Korçë | Huan Agolli | 1,011,000 |
| Dibër | MYFTAR SINANI | 3,660,480 |
| Korçë | Llazar Morcka | |
| Korçë | Viktor Xhelati | 440,000 |
| Korçë | Fehim Aska | 223,000 |
| Korçë | Qerim Tahiri | 71,500 |
| Dibër | DYLEJMAN TUSHA | |
| Korçë | Adem Imami | 150,000 |
| Korçë | Xhelil Xhaholli | |
| Korçë | Valentina Duçi | 142,560 |
| Korçë | Vasil Jani | 636,000 |
| Korçë | Ollga Xhelo | |
| Korçë | Gaqo Koroveshi | 91,065 |
| Korçë | Safet Bashtani | |
| Korçë | Aferdita Spaho | |
| Korçë | Hekuran Bashllari | 0 |
| Lezhë | Gjet Mamli | 0 |
| Korçë | Sotir Ruço | 1,874,400 |
| Gjirokastër | Aferdita Xhitomi | |
| Dibër | Fiqiri Çuka | |
| Gjirokastër | Qeriba Gjylaj | |
| Korçë | Ismail Hanelli | 174,821 |
| Korçë | Ylvije Talelli | 250,357 |
| Korçë | Hysen Shutko | |
| Korçë | Vasil Morcka | 450,753 |
| Korçë | Shyqyri Hoxhalli | 453,907 |
| Korçë | Nefi Bacelli | 212,929 |
| Korçë | Shyqyrie Abedini | 98,802 |
| Korçë | Selvika Ziu | 168,095 |
| Korçë | Andon Naumi | 273,294 |
| Korçë | Bari Sulollari | |
| Korçë | Medat Mero | 5,827,721 |
| Korçë | Gjergj Nikolli | 1,431,560 |
| Korçë | Hysen Lipo | 394,474 |

| | | |
|---|---|---|
| Korçë | Servet Lari | 1,376,491 |
| Korçë | Hekuran Zenelaku | 653,973 |
| Korçë | | 468,504 |
| Korçë | Zani Barolli | 214,041 |
| Korçë | Mazllem Zypçe | 222,539 |
| Dibër | ZABIT AHMET BICI | 23,115 |
| Dibër | TAHIR RAMADAN ZENELI | |
| Dibër | AGIM GJOKA | 335,097 |
| Korçë | Nazif Shaholli | 17,408 |
| Korçë | Gurazi Demiraj | 420,339 |
| Korçë | Adem Abidin | 1,710,040 |
| Korçë | Leonard Pasterma | 778,302 |
| Lezhë | Bardh Ndoji | 292,485 |
| Vlorë | Bastri Hasani | 0 |
| Lezhë | Kol Zef Gjinaj | 193,128 |
| Gjirokastër | Petrit Maliq Sinomataj | |
| Korçë | Ibrahim Subashi | 858,280 |
| Korçë | Hekuran Gjiriti | 1,054,134 |
| Korçë | Spiro Sorba | 324,916 |
| Korçë | LLAZI KOVACI | -255,200 |
| Korçë | Skënder Shkëmbi | 460,800 |
| Korçë | Gjergji Burda | |
| Korçë | Ligor Mançe | 20,000 |
| Korçë | Janulla Gjata | 33,200 |
| Korçë | Hajrije Lisi | 100,000 |
| Korçë | Ajdin Mecollari | 400,000 |
| Korçë | Jonel Nasto | 432,870 |
| Korçë | Todi Çollaku | 47,322 |
| Korçë | Dalip Shkembi | 66,500 |
| Korçë | Fevri Bylykbashi | 55,400 |
| Korçë | Shenjtor Hoxhalli | 91,408 |
| Korçë | Ylber Mullalli | 31,520 |
| Korçë | Engjell Bushi | 0 |
| Korçë | Hekuran Mullalli | 418,000 |
| Korçë | Xhevat Agolli | 1,567,744 |
| Tiranë | HAKI XHAJA | -75,775 |
| Tiranë | KOMUNITETI MYSLYI | -1,494,400 |
| Korçë | Xhemal Qyteza | 374,724 |
| Korçë | Kisha Ortodokse | 584,800 |
| Korçë | PETRI TOMORRI | 123,633 |
| Korçë | Petraq Pine | 907,727 |
| Korçë | LEFKOTHE PETE | 190,330 |
| Korçë | Medeat Bylyku | |
| Korçë | Nafiz Tale | 570,256 |
| Korçë | | 1,335,236 |
| Shkodër | Hydajet Kuqi | |
| Gjirokastër | Fejzo Zaçaj | |
| Gjirokastër | Xhafer Beqo Osmani | 338,616 |

| | | |
|---|---|---|
| Korçë | Fadile Spaho | 818,537 |
| Korçë | Leni Rado | 321,745 |
| Korçë | Sotir Toçe | 146,408 |
| Korçë | Vangjel Morcka | 333,809 |
| Korçë | Shefki Dalip Malësia | 7,509,078 |
| Korçë | Gurali Bacellari | 286,959 |
| Korçë | Nevruz Bala | 726,669 |
| Korçë | Safet Malelli | 1,454,295 |
| Vlorë | Meto Duka | -7,006,940 |
| Korçë | Vangjel Saqellari | 5,000,000 |
| Korçë | Vaskë Melo | 1,241,392 |
| Korçë | Pandora Minka | 1,153,418 |
| Korçë | | 2,463,858 |
| Korçë | Elise Taluri | 279,168 |
| Korçë | Nazar Ismail | 1,124,232 |
| Korçë | Hajredin Rusi | |
| Korçë | Dilaver Baruti | |
| Korçë | Gezim Sulillari | 1,332,308 |
| Kukës | Asllan Qema | |
| Kukës | Sali Neza | |
| Kukës | Ali Neza | |
| Kukës | Sadik Neza | |
| Durrës | Atdhe Hoxha | |
| Berat | Dalip Mystafaraj | 527,067 |
| Korçë | Buajr Bejleri | 494,560 |
| Korçë | Mustafa Veliu | |
| Vlorë | Vedat Beqi | -518,800 |
| Korçë | Xhelal Dedelli | -8,507,600 |
| Korçë | Milo Lluka | 135,200 |
| Korçë | Avdyl Avxhi | 170,000 |
| Korçë | Hysen Oranlli | 369,900 |
| Korçë | Mustafa Xhihani | 98,040 |
| Korçë | Sotiraq Prifti | 73,220 |
| Korçë | Nure Kupe | 360,000 |
| Korçë | Muharem Kupe | 240,000 |
| Korçë | Celnike Kupe | 360,000 |
| Korçë | Ilia Nasto | |
| Korçë | Petraq Duni | 65,200 |
| Shkodër | Jakup Rroji | 12,002,986 |
| Dibër | AHMET LUSHA | |
| Dibër | RASIM TOMCINI | |
| Korçë | Fotini Danushi | 133,650 |
| Dibër | AQIF CAKONI | 280,046 |
| Dibër | Hasan Hysen Nika | |
| Dibër | FERIT BUSHKASHI | |
| Dibër | HANIFE TROCI | 415,125 |
| Dibër | MEHMET SPAHIU | 726,415 |
| Dibër | ELMAZ DIKA | 3,320,522 |
| Vlorë | Musa Shehu | |

| | | |
|---|---|---|
| Dibër | Fije Vani | 731,276 |
| Dibër | Ismail Nel Klosi | 1,088,274 |
| Dibër | Qamil Doku | 1,496,870 |
| Dibër | Ramadan Çira | 305,330 |
| Dibër | Rustem Mcuku | |
| Dibër | Arif Shulku | -13,631,380 |
| Durrës | Bajram Dana | |
| Durrës | Skënder Seseri | |
| Durrës | Agim Picorri | 96,264 |
| Elbasan | SKENDER TOROMANI | 46,419 |
| Elbasan | HAXHI ZAIMI | 147,828 |
| Elbasan | MEHMET HOXHA | 2,304,584 |
| Elbasan | FERIT DERMYSHI | 1,827,825 |
| Elbasan | SHABAN TOROMANI | 949,415 |
| Elbasan | LEFTER NAZARI | 322,747 |
| Elbasan | YMER CALA | 473,100 |
| Elbasan | HYQMET KACANIKU | 2,938,078 |
| Elbasan | BAKI GURI | 3,316,466 |
| Elbasan | SELMAN XHELILI | 129,270 |
| Elbasan | NURI TACE | 238,026 |
| Korçë | Petraq Bushi | 133,650 |
| Korçë | | 2,783 |
| Korçë | Neki Pupa | 789,668 |
| Korçë | | 453,377 |
| Korçë | | 19,404 |
| Korçë | | 48,963 |
| Korçë | | 7,093,056 |
| Korçë | | 502,755 |
| Korçë | Gëzim Çela | 314,301 |
| Korçë | | 296,539 |
| Korçë | | 295,975 |
| Durrës | Miranda Dulla | |
| Vlorë | Fatime Mici | -6,305,240 |
| Vlorë | Vasil Lango | |
| Vlorë | | -81,165 |
| Elbasan | SPIRO XHUFKA | 6,670,326 |
| Durrës | Shkëlzen Jakova | |
| Vlorë | Agim Toro | 5,907,901 |
| Korçë | Miço Kurila | |
| Berat | Jaup Katillari | 7,938,215 |
| Berat | Aziz Dardha | 701,021 |
| Berat | Karafil Arapi | 196,203 |
| Korçë | LUAN AGOSTRA | 380,925 |
| Tiranë | PETRIT CITAKU | 1,976,827 |
| Tiranë | XHEVDET LIBOHOVA (NEKI) | |
| Tiranë | QAMIL ALLUSHI | 5,511,305 |
| Tiranë | SHAQIR ZENELI | 5,397,557 |
| Tiranë | MUSA AHMET HERRI | |
| Tiranë | | -10,315,467 |
| Tiranë | | 647,707 |

| | | |
|---|---|---|
| Tiranë | SEFER ALVORA | -8,590,720 |
| Tiranë | TRASHEGIMTARET AL | 222,539 |
| Tiranë | ZOJE DEMIRI | 1,882,692 |
| Tiranë | XHAFERR AGA | 457,100 |
| Tiranë | MAHMUT LOKU | 557,496 |
| Gjirokastër | Qamil Kalaja | 121,918 |
| Gjirokastër | Sotir Saqellari | 207,317 |
| Lezhë | Ali Sula | |
| Dibër | SHABAN ZYBERI | 788,172 |
| Korçë | MUHARREM MULLA | |
| Korçë | Muharrem Mulla | -1,251,075 |
| Dibër | NJAZI SUL TASHA | 51,763 |
| Dibër | XHELAL NURÇE BALLIU | |
| Dibër | SKENDER JASHAR ZENELI | |
| Dibër | ARBEN QAMIL BALLIU | |
| Lezhë | Rrok Zef Gjoka | |
| Kukës | Qamil Sheta | 3,042,880 |
| Korçë | Ismail Fero | 629,496 |
| Korçë | | |
| Korçë | Oresti Baboci | 42,448 |
| Korçë | Adil Sadik | 239,842 |
| Lezhë | Prenc Jaku | |
| Tiranë | ABDULLA ZAJA | 1,047,762 |
| Tiranë | MAKBULE SEFA | |
| Tiranë | METANI | -2,933,760 |
| Tiranë | PETRIT MULLA | 2,396,268 |
| Tiranë | HAKI ALIZAJ | 693,206 |
| Tiranë | GANI ALLMUÇA | |
| Tiranë | HYSEN SHEHI | 390,820 |
| Tiranë | QAMILE YMERAJ | 195,125 |
| Tiranë | XHERACINA SPAHIJA | 1,682,374 |
| Korçë | | 272,781 |
| Korçë | | 506,310 |
| Korçë | | 224,593 |
| Korçë | Enver Alickolli | |
| Fier | Trashgimtaret | |
| Fier | Trashgimtaret | 1,091,072 |
| Tiranë | NURIE HAJDAR SULTA | 1,544,167 |
| Tiranë | XHEMAL ALI PAZARI | 764,524 |
| Tiranë | SKENDER ÇULLHAJ | 787,746 |
| Tiranë | MAKBULE SEFA | 330,913 |
| Tiranë | ZIJA ÇULLHAJ | 1,436,249 |
| Tiranë | ZYDI EGRA | |
| Tiranë | TIRE BEGA | 7,382,331 |
| Tiranë | IBRAHIM SEJDINI | 62,682,984 |
| Tiranë | RESHIT SHKOZA | |
| Korçë | Nestan Kolami | 440,400 |
| Elbasan | PARTIZAN KAPTELLI | 527,006 |
| Berat | Faik Germenji | 1,424,448 |

*(vijon)*

Opinioni i Ditës

# A duhet lejuar komuniteti LGBT të zhvillojë orë të hapura në shkolla?

NGA VALBONA NATHANAILI

*(vijon nga faqja 1)*

... i ngritur nga prindërit është: A duhen lejuar apo jo të hyjnë në shkolla dhe të flasin! Shqetësim i drejtë!

Fillimisht përvoja evropiane. Në Konventën Europian "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore", paragrafët për arsimin gjenden në kapitullin 14, nën titullin "E drejta për arsim", Protokollet 1 dhe 2, shkruhet: "Asnjë personi nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e çdo funksioni që lidhet me arsimimin dhe mësimdhënien, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë lloj arsimi dhe edukimi, në përputhje me bindjet e tyre filozofike dhe fetare". Pra, sipas përkufizimit, shteti nuk mund të ndalojë asnjë njeri nga ushtrimi i të drejtës së tij për t'u arsimuar, shteti është ai që përcakton natyrën dhe fushën e veprimtarisë në arsim, gjithsesi pa u angazhuar që çdo fëmije t'i japë arsimin që dëshiron, ndërkohë që u garanton të drejtën prindërve t'u respektohen bindjet në lidhje me arsimimin e fëmijëve të tyre.



Sa i takon këtyre të drejtave, një rast interesant është ai i disa prindërve të një shkolle në Danimarkë. Në Danimarkë, shteti ka bërë pjesë të kurrikulës orën e edukimit seksual në shkollën e mesme të ulët. Por ka vendosur edhe disa kushte. Gjatë dhënies së kësaj ore mësimi: nuk duhet të ketë pornografi; nuk duhet që mësuesi ta zhvillojë orën e mësimit vetëm për vetëm me nxënësin; nuk duhet që mësuesi të japë informacion për metoda të ndryshme të kryerjes së marrëdhënieve seksuale; duhet që mësuesi të ketë shumë kujdes me fjalorin, duke mënjanuar përdorimin e fjalëve vulgare. Disa prindër, me bindjen se fëmijët e tyre nuk duhej të ndiqnin një mësim të tillë, sepse binte në kundërshtim me pikëpamjet që kishin për edukimin, e kundërshtuan një praktikë të tillë. Por duke qenë se shkolla i përjashtoi fëmijët, prindërit vendosën të hedhin shtetin në gjyq në Gjykatën Europiane. Gjykata i dha të drejtë shtetit, sa kohë që nuk bëhej fjalë për indoktrinim, apo mbrojtje të një lloji të veçantë sjelljeje seksuale që mund të konsiderohet si mungesë respekti ndaj bindjeve të prindërve.

E solla rastin e Danimarkës, fillimisht për të ndërgjegjësuar prindërit për të drejtat që kanë ndaj shkollës, për rrugët që mund të ndjekin kur mendojnë se shkolla nuk u respekton bindjet dhe moralin, si dhe për të evidentuar një element tjetër shumë të rëndësishëm: kujdesin që tregon shteti për çështje që kanë ngjyrime të theksuara etike, konkretisht duke vendosur disa kushte të caktuara vetëm për zhvillimin e kësaj lënde. Veçanërisht në ditët e sotme, kur shoqëria është bërë shumë komplekse dhe heterogjene.

Në rastin tonë, edhe ne e kemi nënshkruar Konventën Europian "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore". Pra, prindërit shqiptarë kanë të drejtë t'u respektohen bindjet e tyre morale dhe fetare në lidhje me edukimin e fëmijëve dhe njësoj si prindërit danezë kanë të drejtë t'u drejtohen institucioneve të ndryshme ligjzbatuese për të kërkuar të drejtat e tyre. Sikur edhe për të krijuar precedentin e parë. Në dijeninë time, nuk di ndonjë prind t'i jetë drejtuar ndonjë Gjykate se fëmijës së tij i janë shkelur të drejtat në një shkollë shqiptare.

Në rastin e leksioneve a orëve të hapura që kërkon të kryejë komuniteti LGBT, arsyet pro tyre janë: nuk bëhet fjalë për fëmijë të vegjël, por për të rinj të shkollave të mesme, të cilët është më e vështirë të indoktrinohen; nuk është lëndë e detyrueshme, por aktivitet; një praktikë e tillë zhvillohet edhe në shtete të tjera, për shembull në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe quhet "Java e pranimit". Duke e zgjeruar problemin, sot flasim për fëmijë që i nënshtrohen bullizmit e u nxihet jeta në shkollë prej bashkëmoshatarëve, për shkak të orientimit të tyre seksual, por nesër mund të jetë një person i këtij komuniteti që mund të kërkojë të bëhet mësues, do ta pranojmë të japë mësim? Ose të kemi prindër të këtij komuniteti që çojnë fëmijët e tyre në shkollë, do i pranojmë në shkollë?

Shqetësim është mënyra se si trajtohet një temë kaq delikate, që mund të përbëjë edhe një nga arsyet e para për kundër. Kur solla shembullin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe aty ka qenë i njëjti debat: prindërit janë shqetësuar, kanë kërcënuar se do marshojnë kundër shkollës dhe nuk do lejojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë në aktivitet. Por në fund kanë pranuar, me kusht që shkolla të plotësojë disa kërkesa. Problemi është shumë i mprehtë dhe një nga ligjet numër një të etikës është hierarkia që kanë parimet. Të drejtat e më shumëve prevalojnë ndaj të drejtave të më pakëve. E trishtë, por kështu funksionon shoqëria. Në Amerikë, drejtues shkolle dhe prindër u ulën, diskutuan e vendosën së bashku - aktiviteti u krye.

Në ndryshim, këtu te ne, është Ministria e Arsimit që vendos dhe i vendos edhe prindërit përpara faktit të kryer, pa kuptuar se një shoqëri si e jona është shumë e shumë më tepër konservatore në disa drejtime se Amerika a vende të tjera.

Së dyti, edukimi nuk bëhet me aksione. Lufta kundër bullizmit ndaj disa fëmijëve, që kur janë të vegjël, ende të pasigurt për orientimin e tyre seksual, por thjesht sepse kanë një zë pak më të hollë, apo se janë të kujdesshëm në paraqitje, pëlqejnë a manifestojnë sjellje që duken sikur bien në kundërshtim me modelet që kemi, është e ashpër dhe e dhimbshme. Të parët duhet të jenë psikologët e shkollave që t'u paraprijnë situatave të tilla dhe t'i parandalojnë. Pastaj mësuesit. Pastaj drejtuesit. Dhe të gjithë së bashku të punojnë për të shmangur keqtrajtimin e dhunën.

Por për të qenë edhe më të ndërgjegjshëm se sa kaotike është gjendja në shkollat publike, po jap edhe një shembull tjetër konkret. Përpara disa kohësh zhvillova një pyetësor për të matur se sa janë në dijeni mësuesit për reformat që ka ndërmarrë shkolla. Pyetjes sime, se çfarë kupton me "Shkolla qendër komunitare", një nga reformat "më të lavdishme" të Ministrisë së Arsimit, një nëndrejtoreshë ju përgjigj: "Nëse më parë prindërit vinin në shkollë vetëm një herë në dy javë, në takim me prindër, tani mund të vinë kur të duan".

Nëse edhe "java e pranimit" të komunitetit LGBT në shkolla do të kuptohet në këtë formë, prindërit dhe gjithë shoqëria kanë të drejtë të shqetësohen.

Së treti, dikur orë të hapur quanim orën që zhvillonte mësuesi më me përvojë, në një klasë të caktuar, me mësuesit e tjerë të së njëjtës lëndë ose grup-lëndësh, për të sjellë përvojat pozitive. Nuk e di se sa të trajnuar janë njerëzit që po merren me këtë aktivitet, mbi çfarë programi po punojnë, kush e ka aprovuar, sa e si ndiqen nga nxënësit dhe pse e kanë quajtur "orë të hapur". Shpresoj që Ministria e Arsimit të ketë një përgjigje për këtë. Dhe prindërit të mësojnë të kërkojnë të drejtat e tyre.

---

## IN MEMORIAM

### HOMAZH IRFAN BREGUT



Luan Çipi

Diten e diel i eshte dhënë lamtumira e fundit Irfan Bregut, shokut dhe mikut tonë të dashur, gazetarit, poetit dhe mësuesit vlonjat, që gjithë jetën e tij u përpoq për fjalën dhe mendimin e lirë, për jetë më të mirë për Atdheun dhe për Vlorën tonë të bukur, që i skaliti dhe i bëri të pavdekshëm me shkrimet, poezitë dhe penën e tij të artë.

Irfan Bregu lindi në qytetin e Vlorës në vitin 1938 , u rrit dhe u burrërua këtu në Vlorë dhe në Kryeqytet dhe po këtu , në "betlehemin e lirisë', pati fatin të mbyllì sytë dhe të sigurojë përjetësinë.

Duke mos u ndalur te gazetaria dhe mësuesia, që zunë një periudhe të gjatë pune për Irfan Bregun, ajo çka do ngelet e pavdekshme në krijimtarinë e tij letraro artistike është poezia me peshë, me specifikë poemën e bukur gjurmëlënëse, të mbushur me ide atdhetarie e dashurie dhe me bazë figurat artistike letrare dhe metaforat tërheqëse, që s'harrohen lehtë. Irfani nisi te shkruaj dhe nuk pushoi për 50 vjet rresht, ku zene vend nderi: 15 poema, libra shkollore , tekste e antologji, fjalorë gjuhësor enciklopedik, disa libra me poezi, tri librat për Kosovën, etj.

Në krijimet e tij të fundit poeti, duke luftuar me gjendjen e tij shëndetësore, të rënduar, vërente si qytetar, poet e shkencëtar me keqardhje, shkallën e pamjaftueshme të demokracisë shqiptare, shtimin e padrejtësive dhe krimit dhe drogës, me merakun që këto të zgjidhen e të ndreqen sa më shpejt, të merrte fund grindja shekullore dhe te kishte mirëkuptim të plotë shoqëror, me shpresë dhe besim që "lulet e zeza" të bëhen sa më shpejtë të bardha.

I shprehim ngushëllime, në emër të Grupit te Shokëve të Tij me banim në Tiranë, Dritës, gruas së tij të denjë e heroike, djemve, familjes dhe te afërmve dhe gjithë qytetarëve vlonjat që e kishin Irfan Bregun, si djalin e tyre të dashur.

Opinioni i Ditës

# Vetëvrasja - turpi që na mban ende mbërthyer

*(Vetëvrasja kurrë nuk duhet të publikohet nga media si një mjet për të shkuar drejt lirisë)*
**Dr. Bill Schmitz (psikolog klinik)**

Nga Monika Stafa

*(vijon nga faqja 1)*

*… lartësi pak muaj më vonë të kryente vetëvrasje, në një nga rrethinat pranë kryeqytetit shqiptar. Vetëvrasjet e grave kanë vazhduar në kryeqytet gjatë vjeshtës, por edhe në Fier e jo vetëm, nëpër provinca të tjera të Shqipërisë. Muaji janar, i përcaktuar si muaji më i mërzitshëm në kalendarin vjetor prej astrologëve, solli më shumë se katër vetëvrasje të tjera të po kësaj gjinie, përfshi Tiranën, qytetin bregdetar, Durrësin dhe një tjetër qytet jugor të vendit, Tepelenën. Pak ditë më parë ndërroi jetë një grua tjetër në meso moshë, duke zgjedhur t'i jepte fund jetës nëpërmjet rënies nga lartësia.*

Thuajse javë për javë për të mos thënë më shpesh se kurrë në shtypin 'online' të përditshëm do të ketë një njoftim të tillë. Ndodhin ngjarje të tilla në veri e në jug, në fshat e në qytet, në brezin e parë e të dytë të familjes. Të duket sikur përditë përsëriten këto fenomene të përbindshme të njerëzimit, 'krimi' i vetëvrasjes, mëkati fillestar, delikti i kohërave kur kjo shoqëri që ka mbërritur deri në ditët e sotme ende ishte shumë larg jo "familjes së shenjtë e të shëndetshme", por shumë larg edhe kohëve pagane, atëherë kur dënohej me jorespekt ceremonial ai/ajo që merrte përsipër të kryente një veprim të tillë. E madje, kjo traditë për kurorën perandorake në Europë zgjati deri në fillim të shek. të XIX, me Habsurgasit ku Arqiduka Rudolf i Austrisë, u desh të shpallej i sëmurë mendërisht që t'i kryhej ceremoniali kishtar, meqë kish kryer vetëvrasje së bashku me të dashurën e tij.

Ndërsa përcillen tek lexuesi mes portaleve apo çfarëdo medie tjetër tradicionale apo jo, të tilla lajme të gjëmshme, në mendje rregullisht si një tërmet tronditës vërviten pikërisht pyetjet me të cilat i nis dhe këto shënime. Në mënyrë torturuese më mundojnë këto pyetje kur, në asnjë edicion informativ apo qoftë edhe në mediumet e përshkuara më lart, nuk ka asnjë zë psikologu, sociologu, antropologu, mbrojtësi të të drejtave të të miturve, të të drejtave të grave, organizatat joqeveritare për një familje të shëndoshë, për barazi shansesh, për asistencë në traumë, ndërsa të gjithë pështpëritin të njëjtën idiomë: vetëvrasjet?! Po, tek gratë më shumë, pse po rritet kaq shumë numri i tyre nga muaji në muaj, nga viti në vit?! - Ja ç'po ndodh! Atëherë e ndjen veten si ajo skulptura e Laokoontit, që ankohet prej mijëra vjetësh se nuk e kuptoi askush. Të gjithë shkojnë para saj dhe fotografojnë pamjen dhe mashtrimin, por askush nuk mundohet të gërvishtë pak më thellë.

Vetëvrasja po shkatërron edhe mendimin se jeta ofron zgjidhje alternative të vazhdueshme dhe brendia morale e problemit nuk është kaq e zorshme sa duket! Pavarësisht se marrëdhëniet brenda gjakut ditën dhe natën, mes të rinjve dhe të vjetërve, çdo javë, çdo muaj, pambarim po shkojnë drejt frustrimit të pandalshëm! Dhe lajmësit e kumtuesit, pa e vrarë aspak mendjen, këtë konfirmojnë. Familja shqiptare është nën peshën e krimit midis vetes, por edhe ndaj vetes: vetëvrasjet, dhuna seksuale është përhapur brenda gjinisë; pa folur për atëvrasës e mëmëvrasës të panumërt, që tmerrojnë dita me ditë njerëzinë. Por analizës i duhet shkuar deri në thelbin e saj! Nëse është e vërtetë që ndër shqiptarët, vetëvrasjet, incesti dhe krimi vrastar brenda gjakut është aq i përhapur sa njoftohet e komentohet rregullisht në shtyp, atëherë dikush duhet të kujtohet më së fundi të pyesë: këto krime me të cilat e ka ndarë veten njerëzimi qysh prej kohërave biblike, prej mbarimit të matriarkatit, prej krijimit të tabusë universale të përjashtimit të fëlligështisë në gjak, prej daljes së botës prej kompleksit të Edipit dhe shpëtimit të njeriut nga fataliteti i marrëdhënies brenda familjes, prej konsakrimit dhe shenjtërimit të familjes monogame, me kaq përhapje sa kanë, a nuk janë shenjë e një zgjimi barbar çmendurak, shenjë e një lajthitjeje të përgjithshme, që duhej të kish tronditur gjithë bashkësinë?!

Duhej të kalonin shekuj për të ardhur tek krishtërimi dhe shenjtërimi i familjes kur Europa e vjetër tronditej, frikësohej dhe purifikohej, duke e parë në skenë teatri si krim jetësor, tmerrin e pafund të dy familjeve armiqsore në Verona të Italisë, Montague-ve (Romeo) dhe të Capulet-ve (Zhulјeta). Gjakmarrja shkoi aq larg, saqë pjesëmarrësit rregullisht i kushtoheshin njëri-tjetrit me pasion në fyerje dhe luftëra shpate të përgjakshme sapo takoheshin në qytet. Për këtë arsye, Romeo dhe Zhulјeta e mbajtën lidhjen e tyre të dashurisë të fshehtë nga prindërit. Pa dijeninë e tyre u martuan nga prifti Lorenco, që fshehurazi u përpoq të ndihmojë në zgjidhjen e konfliktit. Karakteret e William Shakespeare-s bëjnë vetëvrasje në disa nga dramat e tij. Ndoshta më fatkeqët ishin këta të dashuruar të rinj, Romeo dhe Zhuliet, të cilët bënë vetëvrasje në skenën përfundimtare të historisë së tyre. Vetëvrasje ndodh edhe tek "Jul Cezar" kur Brutus dhe Cassius të dy bashkë, vrasin veten. Otello kryen vetëvrasje me një kamë pasi vrau të dashurën e tij në një krim pasioni. Vepra "Antoni dhe Kleopatra" përfundon me pesë vetëvrasje, duke përfshirë këtu edhe vdekjen e Antonit dhe Kleopatrës. Ofelia, një tjetër brishtësi e bukur, kryen vetëvrasje tek "Hamleti" pas vdekjes së babait të saj. Atë që këta autorë si Shekspiri apo dhe grekë të vjetër e shihnin si gjëmë vrastare në skenë, ne, ata që njoftojnë ngjarjet dhe ata që i komentojnë ato e shohin përditë para syve, në kasolle, në apartamente, në autovetura, në dyer komisariatesh policie, si realitet parësor.

Ky refren eufemik që përsëritet, gjithmonë për ata që 'mendojnë' më shumë nuk pranohet! Është një stad që bota e ka kaluar një herë e mirë, sepse ajo që quhet "vetëvrasje" mund të ndodhë vetëm si një 'krim' tejet i rrallë, mbase më i rralli ndër të gjitha krimet, në raste të sëmundjeve patologjikisht fatale, nga të cilat, për fat, arsyeja dhe shëndeti njerëzor janë përgjithësisht të vetëmbrojtura prej vetë rrugës që ka ndjekur njerëzimi. Mirëpo, nëse "vetëvrasja" nuk ka këtë shpjegim të rëndomtë dhe gjenetikisht e racërisht penalizues, çfarë mund të jetë vallë? Diçka më e lehtë? Diçka më e fshehtë?! Me sa duket po.

Në veprën e tij "Totem e tabu" psikanalisti i mirënjohur Zigmund Freud ka përcaktuar rrugën historike të krijimit të tabuve njerëzore, njëra prej të cilave, në mos themelorja është përjashtimi apo ndalimi i vetëvrasjes, por jo më pak dhe përjashtimi e ndalimi i krimeve të tjera në familje. Arsyetimi i frojdistëve dhe i neofrojdistëve, që me sa duket është më bindësi edhe për historitë shqiptare me këtë lloj 'krimi' në familje, është se përgjithësisht ato krime që paraqiten si të tilla, në të vërtetë në shumicën e rasteve nuk janë aspak si duken. Sepse rruga historike e ngulitjes së tabusë (ndalimit) ka krijuar tek njeriu fiziologjikisht mekanizmat vetëmbrojtës, mekanizmin e pamundësimit të kryerjes së një akti të tillë kur njeriu edhe në zgrip të mendjes së tij, i aktivizon ato. Edhe sikur vetëdija t'ia nxisë njeriut prapësinë, historia njerëzore ka bërë përkryerjen psikologjike dhe fiziologjike, që ta bëjë të pamundur këtë 'krim', përmes sistemesh frenimi, që nuk mund t'u gjesh shpjegim racional të pastër.

Ka një krim tjetër që fshihet pas "vetëvrasjes", sipas analizës frojdiste dhe postfrojdiste. Duket se njeriu kryen këtë akt-krim, por në fakt, përveç rasteve të sëmundjes patologjike, kur kjo marrëdhënie arrin të kalojë tabunë e të realizohet, vetëvrasje nuk është. Thjesht fotografohet e lexohet kështu. Në thelbin e vet këto fakte njoftojnë për një shtrembërim shumë më të hershëm në familje. Në thelbin e tyre gjërat janë pak më ndryshe. Ka një shprishje gjaku në mes, që realitetin nuk e duron dot më. Në familje ka shtrembërime dhe fiktivitete të rënda. Dhe ky shtrembërim i hershëm paraqitet si vetëvrasje. Cilat janë ato? Analizat psikologjike frojdiane kanë shpjegimin e tyre, por që shoqëria jonë, apo edhe njerëzit e profesionit nuk kanë kohë t'i shtjellojnë.

Të gjitha këto raste "vrasje" dhe "vetëvrasje", apo anasjelltas, janë njëherësh edhe çështje të kriminalistikës. Viktimat ikin duke lënë pas dyshimet e një bote dhe dilemat për një të ardhme më të mirë, familjet shkatërrohen por zgjidhjet nuk mësohen asnjëherë që ky fenomen të mos dendësohet siç ka ndodhur së fundmi. Lajmet që jepen sigurisht përbëjnë lajm, por pas duhet të shoqërohen me analizë që ato të mos intensifikohen dhe të mos shihen nga grupe vulnerable të tilla, si çlirim drejt lirisë vetjake nga një botë që s'të nxë më. A ka ndodhur qoftë edhe në një rast të vetëm që një institucion të ketë kërkuar, psh., të bëhen analizat mbi këtë gjindje tek kjo gjini bazuar mbi shifrat e fundit të ofruara, për të provuar përfundimisht nëse vërtet është rasti i një të sëmuri a snobi që ka shkuar në kufijtë e vetëvrasjes? Një gjë e tillë nuk ndodh ndër ne. Ne ende kemi një turpërim tërësor prej këtij akti, që trondit themelet e racës dhe të bashkësisë sonë. Ne ende turpërohemi nga një hetim për të zbuluar të vërtetën. Ndaj duhet kërkuar krimi tjetër përtej aktit të vetëvrasjes për ta çliruar këtë shoqëri nga makthi i barbarisë… ju psikologë, sociologë dhe antropologë.



## HOROSKOPI

### DASHI
Nuk është e thjeshtë të ruash përqendrimin tek çështjet më urgjente, nëse nuk do t'ua ktheni me një "jo" strategjike atyre që do t'ju kërkojnë ndihmë. Përkushtojini më shumë kohë vetes dhe pasioneve që keni dhe shijoni gjërat e vogla që ju ofron jeta.

### DEMI
Keni nevojë për një ndryshim ambienti, që ju rikthen entuziazmin ideve të reja që keni, për të mos humbur gjallërinë që ju shquajnë nga të tjerët. Më në fund erdhi një ditë e qetë, pikërisht ajo që ju duhet për të qëndruar më shumë me të dashurit tuaj.

### BINJAKET
Fjalët e bukura dhe vështrimet e ëmbla nuk ju mjaftojnë? Mos kërkoni shumë nga partneri, nëse nuk doni të krijoni tensione që nuk kanë arsye të jenë. Të kënaqeni është e rëndësishme, nëse doni të ndërtoni themelet mbi të cilat të ngrini një raport të qëndrueshëm.

### GAFORJA
Duke mos u dashur të zgjoheni herët për të shkuar në punë, mund rrini të qetë dhe të mos lodheni shumë. Keni nevojë për të pushuar pak. Por nëse bie alarmi i orës, pasi edhe sot ju thërret detyra, mendoni të pini një kafe të mirë dhe do të merrni zemër.

### LUANI
Të favorizuar nga Saturni, zgjidhja e një çështjeje që ju shqetësonte do të jetë e thjeshtë, sepse jeni të fortë nga besimi që ju japin shumë persona. Duke mundur të merrni nën kontroll situatën, do të keni çdo gjë nën vëzhgimin tuaj të kujdesshëm dhe vigjilent.

### VIRGJERESHA
Keni zbuluar te personi i dashur një anë, ekzistencën e së cilit e keni shpërfillur? Nuk ka problem, do të shërbejë për ta bërë marrëdhënien tuaj më të plotë. Gjatë kësaj periudhë jeni shumë të shpërqendruar. Tregohuni të vëmendshëm, nëse do të angazhoheni në atë që bëni.

### PESHORJA
Me Hënën në harmoni me Plutonin dhe Venusin, mund të keni më shumë vullnet për të përmirësuar fushën e ndjenjave dhe të dashurisë. Në shtëpi keni një atmosferë të qetë, duke qenë se dini si ta krijoni.

### AKREPI
Në vend që të rrini i ngulitur tek telefoni dhe rrjetet sociale, vendosni të dilni, nëse doni të bëni një takim romantik, apo edhe vetëm thjesht për t'u argëtuar pak. Raste do të keni, por ndoshta ju mungon perceptimi për t'i vënë në pah në kohën e duhur.

### SHIGJETARI
Pozicionimi i Hënës në lidhje me Plutonin bën që të jeni i pandalshëm përgjatë rrugës së ndërmarrë dhe nuk do të ndaloni edhe përpara të papriturave. Me ngadalë, por pashmangshmërisht, do të anashkaloni pengesën për të shkuar drejt qëllimit.

### BRICJAPI
Ndjenja juaj për drejtësi do t'ju ndihmojë të zgjidhni me shpejtësi një çështje delikate, në të cilën nuk do të kishit dashur fare të ishit përfshirë. Pak rëndësi ka nëse mënyra juaj e të vepruarit nuk arrin të kënaqë gjithkënd. Ajo që ka rëndësi është integriteti juaj.

### UJORI
Të mbështetur nga Hëna, do të jetë e lehtë të shkoni mirë me partnerin tuaj, edhe pas një zënkë të vockël, sepse të grindeni nuk do të thotë se nuk duheni. Jeni gati të hapni rrugë për personin tuaj të zemrës, për ju dashuria vjen para çdo gjëje.

### PESHQIT
Po mendoni sesi ta bëni sa më të veçantë festën e ditëlindjes? Fillimisht mendoni për menynë dhe mbi të gjitha për tortën! Shpresoni të merrni që dhuratë të rëndësishme, por për të qenë të sigurt, hidhjani si fjalë larg e larg të tjerëve.

Kuqezinjtë janë të pafuqishëm dhe vuajnë gjatë gjithë takimit lojën e nordikëve

# Norvegjia "samba" në shi ndaj Shqipërisë

## *Incidenti, Xhaka përplaset me policinë*

**NDESHJA**
Norvegjia ishte shumë më e qartë dhe loja u zhvillua kryesisht në gjysmëfushën e Shqipërisë, ndërsa kuqezinjtë bënë shumë pak për të rrezikuar kundërshtarin. Aspak i kënaqur edhe trajneri Panuçi, që vazhdimisht u tërhoqi vëmendjen futbollistëve, ndërkohë që po planifikon edhe ndryshime në pjesën e dytë.

Jeton Selimi

Ka përfunduar me humbje, testi i parë i Shqipërisë për vitin 2018, teksa në Norvegjia ka triumfuar 0-1 në miqësoren e luajtur në 'Elbasan Arena'. Nën reshjet e vazhdueshme të shiut, skuadra e Panuçit nuk ka arritur për asnjë moment të dalë në lojën e vet, teksa mesfusha vuajti shumë presingun e kundërshtarit dhe nuk arriti të organizohej asnjëherë shpejt. Nga ana tjetër, Norvegjia nuk vodhi asgjë, pasi dominoi sfidën dhe kontrolloi lojën nga fillimi në fund, duke merituar fitoren e marrë në takimin e sotëm. Në pjesën e parë, Norvegjia ishte shumë më e qartë dhe loja u zhvillua kryesisht në gjysmëfushën e Shqipërisë, ndërsa kuqezinjtë bënë shumë pak për të rrezikuar kundërshtarin. Aspak i kënaqur edhe trajneri Panuçi, që vazhdimisht u tërhoqi vëmendjen futbollistëve, ndërkohë që po planifikon edhe ndryshime në pjesën e dytë. Ramadani dhe Qaka vuajnë shumë jo vetëm në organizimin e lojës, por edhe në fazën e presingut, ndërsa Sadiku mbetet shumë i izoluar në majë të sulmit. Pikërisht pejani Qaka dëmtohet në fundin e pjesës së parë dhe largohet për t'i bërë vend një tjetër debutuesi, Keidi Bares. Edhe pjesa e dytë ka të njëjtën tablo, teksa Panuçi tenton të freskojë skuadrën, duke hedhur në fushë një tjetër debutues,






Bujar Likën, por edhe Bekim Balën e Andi Lilën. Gjithsesi, në momentin më të mirë të kuqezinjve, është Norvegjia që gjen golin e avantazhit, nëpërmjet anës së saj më të fortë, goditjes standarde. Një krosim nga këndi, goditet nga Rosted, që e dërgon në rrjetën e Strakoshës. Kuqezinjtë tentojnë të reagojnë, por disa gjuajtje nga distanca nuk e kërcënojnë aspak portierin e miqve, ndërsa Eros Grezda i vetëm, nuk mjafton për të nxjerrë përpara skuadrën e Panuçit. Minutat e mbetura nuk sjellin asgjë të re, teksa Norvegjia fiton 1-0 dhe kuqezinjtë e nisin vitin me humbje.

**INCIDENTI**

Me mbërritjen e Kombëtares në "Elbasan Arena", u shënua edhe incidenti i parë. Mesfushori i kombëtares shqiptare, Taulant Xhaka, pasi ka zbritur nga autobusi në të cilin gjendej së bashku me pjesën tjetër të grupit, ka nxituar të takojë disa të njohur. Por futbollisti ka hasur refuzimin e policëve, të cilët nuk kanë lejuar që këta persona të kalonin rrethimin e policisë. Kjo ka shkaktuar disa momente tensioni për Xhakën, i cili ka ngritur zëri duke kërkuar llogari nga policët për veprimin e tyre. Një moment tensioni që është anashkaluar dhe Xhaka ka vazhduar t'i bashkohet pjesës tjetër të grupit.

**MESFUSHORI**

### Ramadani: Fanella e Kombëtares, ëndërr që u bë realitet

Shqipëria e ka humbur miqësoren ndaj Norvegjisë, duke u mundur me rezultatin 0-1 në "Elbasan Arena". Në një intervistë për "Supersport", Ylber Ramadani është shprehur se Kombëtarja e kishte përgatitur takimin e sotëm, por një episod vendosi fatin e ndeshjes. "E dija se Danimarka dhe Norvegjia luajnë të njëjtin futboll, prandaj isha i përgatitur për këtë vështirësi. Duke parë edhe analizën që i bëmë Norvegjisë, ishim shumë të përgatitur. Na kanë goditur me një episod, nëse do të kishte shënuar edhe Ajeti, atëherë gjërat do të kishin ndryshuar. Për mua kjo ishte ndeshja e parë dhe do të synojmë të përmirësohem në çdo ndeshje. Kjo ishte një ëndërr për mua të luaj për Shqipërinë, pasi e kam ëndërruar qysh në fëmijëri, ishte një ndjenjë e veçantë", është shprehur Ylber Ramadani.

## Drejtori i Partizanit Rama: Panuçi të grumbullonte edhe Trashin

Drejtori i përgjithshëm i Partizanit, Olsi Rama, shprehet i kënaqur nga loja e Panuçit, e cila është më sulmuese, dhe sipas tij Partizani ka në ekip lojtarë të tjerë që mund të thirren nga Kombëtarja.

Sfida ndaj Norvegjisë

Më pëlqen iniciativa e Panuçit që grumbullon lojtarë të rinj, dhe që luan me një stil tjetër loje, më ofensiv.

Thjesht miqësore, apo edhe për rezultat

Këto ndeshje janë thjesht për të parë se si funksionon ekipi. Rezultati normal që të ndihmon, sepse të jep moral, por duhen parë skemat.

Lojtarët nga Superiorja në Kombëtare

Mendoj se ia vlen të kthehen sytë nga kampionati shqiptar. Cilësia është rritur. Së shpejti të ketë edhe më tepër lojtarë. Mund të përmend Trashin, i cili ka goxha cilësi, por shpresoj që me kalimin e kampionatit, të tregojë akoma më shumë vlera që të thirret në Kombëtare. Bardhi është me Shpresat, ndoshta edhe Mala kalon tek Shpresat. Por kemi lojtarë që mund ta meritojnë së shpejti Kombëtaren e madhe.




**LOJTARET**

"Cilësia është rritur. Së shpejti të ketë edhe më tepër lojtarë. Mund të përmend Trashin, i cili ka goxha cilësi, por shpresoj që me kalimin e kampionatit, të tregojë akoma më shumë vlera që të thirret në Kombëtare.




## Justifikimi i Panuçit: Lojtarët nuk kanë minuta në këmbë

Shqipëria e ka humbur miqësoren ndaj Norvegjisë, duke u mundur me rezultatin 0-1 në "Elbasan Arena". Në një intervistë për "Supersport", Panuçi është shprehur se Shqipëria e ka humbur takimin e sotëm në aspektin fizik, ndërsa këtë humbje ia ka faturuar, gjithashtu, edhe minutave të pakëta që kanë futbollistët e Kombëtares. "Kemi ndryshuar dy herë formulën e lojës, hera e dytë ishte më e rrezikshme, por kemi bërë shumë pak për të fituar ndeshjen. Diferenca ishte vetëm në nivelin fizik, kjo u pa, shumë futbollistë nuk kishin minutat e duhura dhe kjo bëri diferencën. Kemi nisur me një 4-3-3, pastaj kaluam në 4-3-2-1. Morëm disa përgjigje pozitive dhe negative nga futbollistët tanë. Luajtëm ndaj një kundërshtari shumë të fortë fizik dhe ata nuk na lejuan të shkojmë në lojën tonë. Dua të përsëris edhe njëherë faktin, se futbollistët aktualë nuk kishin minutat e duhura në klubet e tyre. Unë nuk kam 200 futbollistë në dispozicion, por kërkoj t'i ndihmoj futbollistët e mi. Kemi qenë shumë të brishtë në aspektin mbrojtës dhe kjo u vu re në këtë ndeshje", është shprehur Panuçi.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

